



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2022 – Numri: 35

Tiranë – E martë, 8 mars 2022

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 113, datë 2.3.2022	Për planin vjetor të pranimit, për vitin 2022, në institucionet e administratës shtetërore, pjesë të shërbimit civil 4165
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 114, datë 2.3.2022	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 730, datë 3.12.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për hapjen e procedurës së pranimit të drejtpërdrejtë në TND edhe për kandidatë të tjerë jashtë shërbimit civil dhe për përdorimin e procedurës së pranimit të drejtpërdrejtë në TND për vitin 2021” 4166
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 115, datë 2.3.2022	Për një ndryshim në vendimin nr. 187, datë 8.3.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve në disa institucione të administratës publike”, të ndryshuar..... 4166
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 116, datë 2.3.2022	Për transferimin në pronësi të Bashkisë Kolonjë, të Njesisë Administrative Çlirim, të një pjese të pasurisë 261/2, me vendndodhje në zonën kadastrale 1412, dhe të pasurisë 564, me vendndodhje në zonën kadastrale 3068..... 4168
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 118, datë 2.3.2022	Për disa ndryshime në vendimin nr. 379, datë 8.4.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Leskovik, të qarkut të Korçës” 4172
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 119, datë 2.3.2022	Për një ndryshim në vendimin nr. 82, datë 31.1.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e zonës së re për zhvillim në Njesisë Administrative Baldushk, Bashkia Tiranë, dhe caktimin e Bashkisë Tiranë si njësi zbatuese” 4175
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 121, datë 2.3.2022	Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rikonstruksionit të njësive individuale të banimit dhe njësive të banimit në ndërtesa (pallat), në bashkitë Tiranë dhe Rrogozhinë..... 4176

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 122, datë 2.3.2022	Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të shkollës 9-vjeçare “Picar”, Bashkia Vorë, dhe caktimin e Bashkisë Vorë si njësi zbatuese.....	4176
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 124, datë 2.3.2022	Për përcaktimin e afatit të hyrjes dhe qëndrimit të shtetasve të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Republikën e Shqipërisë	4177
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 125, datë 2.3.2022	Për disa ndryshime në vendimin nr. 420, datë 8.6.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Ceremonialit Shtetëror të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.....	4177
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 127, datë 2.3.2022	Për karakteristikat grupore, llojet dhe parametrat teknikë të armëve të ftohta, për të cilat organi kompetent lëshon autorizim për mbajtjen nga shtetasit.....	4178
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 128, datë 2.3.2022	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 953, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 92/2014, ‘Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë’, të ndryshuar”	4179
Udhëzim i përbashkët i ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 4, datë 31.1.2022	Për përcaktimin e kriterëve, kushteve dhe procedurave mbi përjashtimin nga taksat për qumështin pluhur, për hirrë qumështi dhe krem qumështi të fabrikave të prodhimit dhe përpunimit të qumështit dhe nënprodukteve të tij.....	4179
Vendim i Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit nr. 3, datë 25.2.2022	Bibliografia e informacionit të deklasifikuar në AIDSSH.....	4181
Vendim i Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit nr. 4, datë 25.2.2022	Bibliografia e informacionit të deklasifikuar në AIDSSH.....	4182
Vendim i Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit nr. 5, datë 25.2.2022	Bibliografia e informacionit të deklasifikuar në AIDSSH.....	4184
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 24, datë 14.2.2022	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “HEC Terfoja” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Tërfoje”, me kapacitet të instaluar 1980 kw.....	4186
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 25, datë 14.2.2022	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “HEC Terfoja” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.....	4188
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 26, datë 14.2.2022	Mbi përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale për vitin 2021.....	4190

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 27, datë 14.02.2022	Mbi fillimin e procedurës për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli, era dhe nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale për vitin 2022.....	4192
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 28, datë 14.2.2022	Mbi kërkesën e OSSH sh.a., për ndryshimin e vendimit të ERE-s nr. 181, datë 23.11.2016, “Për disa ndryshime në vendimin nr. 104, datë 23.6.2016, të Bordit të ERE-s, ‘Mbi përcaktimin e metodologjisë së vlerave referuese, në rast se të dhënat e matjes janë përkohësisht të padisponueshme dhe të paarrtshme, si dhe mbi shfuqizimin e vendimeve të ERE-s nr. 49, datë 21.10.2004, dhe nr. 146, datë 24.12.2013”	4193
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 29, datë 14.2.2022	Mbi ndryshimin e pjesshëm të përkohshëm të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 146, datë 10.9.2020, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Seka Hydropower’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et ‘Sekë’, me kapacitet të instaluar 12667 kw dhe ‘Zais’, me kapacitet të instaluar 2295 kw, me kapacitet total të instaluar 14962 kw”	4196

**VENDIM****Nr. 113, datë 2.3.2022**

**PËR PLANIN VJETOR TË PRANIMIT,
PËR VITIN 2022, NË INSTITUCIONET E
ADMINISTRATËS SHTETËRORE,
PJESË TË SHËRBIMIT CIVIL**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 18, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Numri i vendeve vakante të planifikuara për rekrutim, gjatë vitit 2022, është gjithsej 855 (tetëqind e pesëdhjetë e pesë), të ndara sipas kategorive të mëposhtme:

- | | |
|---|------|
| a) Për trupën e nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues | 8; |
| b) Për kategorinë e mesme drejtuese | 53; |
| c) Për kategorinë e ulët drejtuese | 190; |
| ç) Për kategorinë ekzekutive | 604. |

2. Grupet e administrimit të përgjithshëm dhe të posaçëm në kategorinë ekzekutive janë, si më poshtë vijon:

- Shkenca juridike;
- Audit i brendshëm;
- Shkenca ekonomike;
- Shkenca ekonomike/juridike;
- Shkenca shoqërore;
- Shkenca sociale;
- Histori-filologji;
- Shkenca mjekësore;
- Veterinari;
- Agronomi;
- Shkenca biologjike dhe të ngjashme me to;
- Kimi;
- Shkenca mjedisore ose të tjera të përshtatshme;
- Shkenca inxhinierike;
- Arkitekturë;
- Arkeologji dhe restaurime;
- Artet e bukura;
- Gjeodezi;
- Shkenca ekzakte;
- Shkenca edukimi;
- Mësuesi;
- Arsimit i lartë ushtarak/policor;

- Arsimit i lartë.

3. Institucionet e administratës shtetërore ku planifikohen vendet vakante, gjatë vitit 2022, janë sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet dhe është pjesë përbërëse e tij.

4. Vendimi nr. 65, datë 2.2.2022, i Këshillit të Ministrave, “Për planin vjetor të pranimit për vitin 2022, në institucionet e administratës shtetërore pjesë të shërbimit civil”, shfuqizohet.

5. Ngarkohet Departamenti i Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR**Edi Rama****Lidhja nr. 1**

**LISTA E INSTITUCIONEVE TË
ADMINISTRATËS SHTETËRORE KU
PLANIFIKOHEN VENDET VAKANTE
GJATË VITIT 2022**

1. Kryeministria dhe institucionet në varësi të saj;
2. Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme;
3. Sistemi i Ministrisë së Brendshme;
4. Sistemi i Ministrisë së Mbrojtjes;
5. Sistemi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë;
6. Sistemi i Ministrisë së Drejtësisë;
7. Sistemi i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë;
8. Sistemi i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
9. Sistemi i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit;
10. Sistemi i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
11. Sistemi i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit;
12. Ministria e Kulturës.

**VENDIM****Nr. 114, datë 2.3.2022**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË VENDIMIN NR. 730, DATË 3.12.2021,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
HAPJEN E PROCEDURËS SË
PRANIMIT TË DREJTPËRDREJTË NË
TND EDHE PËR KANDIDATË TË
TJERË JASHTË SHËRBIMIT CIVIL DHE
PËR PËRDORIMIN E PROCEDURËS SË
PRANIMIT TË DREJTPËRDREJTË NË
TND PËR VITIN 2021”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 5, të nenit 27, e të pikës 1, të nenit 29, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, si dhe në vijim të pikave 2, 3 e 4, të kreut V, të vendimit nr. 118, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e emërimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të anëtarëve të TND-së”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 730, datë 3.12.2021, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Titulli i vendimit ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Për hapjen e procedurës së pranimit të drejtpërdrejtë në TND edhe për kandidatë të tjerë jashtë shërbimit civil dhe për përdorimin e procedurës së pranimit të drejtpërdrejtë në TND për vitet 2021 dhe 2022”.

2. Në pikat 1 dhe 2, fjalët “... vitin 2021 ...” zëvendësohen me “... vitet 2021 dhe 2022 ...”.

3. Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Numri i pozicioneve, për të cilat do të përdoret procedura e pranimit të drejtpërdrejtë në TND, është 16 (gjashtëmbëdhjetë).”.

4. Pas pikës 5 shtohet pika 6, me këtë përmbajtje:

“6. Në rast se numri i pozicioneve vakante të TND-së, sipas pikës 3, të këtij vendimi, nuk plotësohet nëpërmjet procedurës së konkurrimit të nisur në vitin 2021, Departamenti i Administratës Publike zhvillon një procedurë të re pranimi të

drejtpërdrejtë në TND gjatë vitit 2022 për numrin e pozicioneve të mbetura vakante dhe brenda numrit të përcaktuar në pikën 3, të këtij vendimi.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR**Edi Rama****VENDIM****Nr. 115, datë 2.3.2022**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR. 187, DATË 8.3.2017, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E
STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË
PAGAVE TË NËPUNËSVE CIVILË/
NËPUNËSVE, ZËVENDËSMINISTRIT
DHE NËPUNËSVE TË KABINETEVE
NË DISA INSTITUCIONE TË
ADMINISTRATËS PUBLIKE”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”; të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, “Për pagat, strukturat dhe shpërblimet e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lidhja nr. 5/1, që përmendet në pikën 8/1, të vendimit nr. 187, datë 8.3.2017, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2022, të përballohen nga fondet e planifikuara në buxhetin e shtetit për rritjen e pagave për këtë vit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2022.

KRYEMINISTËR**Edi Rama**



Lidhja nr. 5/1

Kategoritë e pagave dhe shtesat për kushte pune të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “Specialist” deri në “Titullar institucioni” në Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit

POZICIONI	KATEGORIA	KRITERI MINIMAL I DIPLOMËS SË SHKOLLËS SË LARTË PËR EFEKT TË PRANIMIT NË POZICIONIN PËRKATËS TË PUNËS PAGA E GRUPIT	SHTESA PËR KUSHTE PUNE
Titullar i institucionit.	I-b	1	75.000
Zëvendëstitullar i institucionit; Drejtor drejtorie në drejtoritë e përmbajtjes në zyrën qendrore të AKSHI-t; Drejtor drejtorie të drejtorive IT të atashuara pranë Kryeministrisë, ministrive të linjës dhe institucioneve qendrore.	II-b	1	115.000
Drejtor drejtorie në drejtoritë mbështetëse.	II-b	1	0
Përgjegjës sektori në sektorët e përmbajtjes në zyrën qendrore të AKSHI-t.	III-a	1	72.000
Përgjegjës sektori në sektorët IT të atashuar pranë Kryeministrisë, ministrive të linjës dhe pranë institucioneve qendrore.	III-a/1	1	20.000
Përgjegjës sektori në sektorët e atashuar pranë drejtorive rajonale të sistemit tatimor.	III-b	1	15.000
			5.000
Përgjegjës sektori të sektorëve të atashuar pranë institucioneve rajonale.	IV-a	1	15.000
			5.000
Përgjegjës sektori në sektorët mbështetës.	III-a/1	1	0
	III-b	1	0
Specialist në sektorët apo drejtoritë e përmbajtjes në zyrën qendrore të AKSHI-t.	III-b	1 ose 2	73.000
Specialist në sektorët apo drejtoritë IT të atashuar pranë Kryeministrisë, ministrive të linjës dhe pranë institucioneve qendrore.	III-b	1 ose 2	25.000
Specialist në sektorët e atashuar pranë degëve doganore.	III-b	1 ose 2	15.000
			5.000
Specialist në sektorët apo drejtoritë IT të atashuar pranë institucioneve rajonale/vendore.	IV-b	1 ose 2 ose 3	15.000
	IV-c		5.000
Specialist në sektorët apo drejtoritë mbështetëse.	IV-a	1 ose 2 ose 3	0
	IV-b		0

Për institucionet rajonale/vendore shtesën prej 15.000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë e përfitojnë vetëm nëpunësit e strukturave TIK, të cilët punojnë me bazat e të dhënave shtetërore.



VENDIM

Nr. 116, datë 2.3.2022

**PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË
BASHKISË KOLONJË, TË NJËSISË
ADMINISTRATIVE ÇLIRIM, TË NJË
PJESE TË PASURISË 261/2, ME
VENDNDODHJE NË ZONËN
KADASTRALE 1412, DHE TË PASURISË
564, ME VENDNDODHJE NË ZONËN
KADASTRALE 3068**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 5, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin në pronësi të Bashkisë Kolonjë, të Njesisë Administrative Çlirim, të një pjese të pasurisë 261/2, me sipërfaqe 316 800 (treqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e tetëqind) m², me vendndodhje në zonën kadastrale 1412, dhe të pasurisë 564, me sipërfaqe 22 089 (njëzet e dy mijë e tetëdhjetë e nëntë) m², me vendndodhje në zonën kadastrale 3068, sipas formularit, gjithsej 1 (një) fletë, dhe planrilevimeve, që i bashkëlidhen këtij vendimi, për t’u përdorur për interes vendor.

2. Ngarkohen Bashkia Kolonjë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

2. FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHETËRORE
(Per inventarizimin e pronave te veçanta te tipit Pyje, Kullota, Livadhe, Shkembore etj.)

Bashkia :Kolonje		Identifikoi: Fation Kasko, Specialist i Kadastres Pyjore (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)		Supervizoi: Muharem Tartari , Drejtor DPKZHT Kolonje (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)		Aprovoi: Erion Isai, Kryetar i Bashkisë (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel., fllaka, vula)		Te dhëna të hjera (Shënim te veçanta)	
Fusha e perdorimit te Prones: Pyll									
Nr. Rend.	Emertesa e Ekonomise Pyjore dhe Kullosore (EPK) Shtirirja Gjeografike e EPK	Emertesa e Ngastres /end ndodhja (sipas emertese popullore)	Numeri i Ngastres	Destinacioni	Siperfaqja ne ha.	Funksioni per te cilin perdoret Prona	Institucioni/ Enti me pergjegjesi administrative	Institucioni/ Enti Perdorues Statusi juridik i perdorimit	Te dhëna të hjera (Shënim te veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
1	Ekonomia Pyjore Ballabanove	Rrahu i Kaltanjit	68c	Pyll	31.68	Prodhues	Bashkia Kolonje	Shtet	
			261/2/A						



1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHETERORE

(Per inventarizimin e pronave te veçanta)

Bashkia Kolonje				Identifikoi:				Erjon Cenko Specialist prane DPKZHT			
				Supervizoi:				Ganiart Eminaj Specialist prane DPKZHT			
				Aprovoi:				Muharem Tartari Drejtor prane DPKZHT			
								Erjon Isai Kryetari i Bashkise (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel., firma, vula)			
Fusha e perdorimit : Ne fushen e bujqesise											
A				B							
Nr. Rend.	Zona Kadastr. & Indeksi i Hartes	Nr. Pasurise	Lloji i Prones	Emri i Prones Adresa	Sip. Totale e Prones (m2)	Nga Sip. Totale: Sa Ndertese (m2)	Funksioni per te cilin perdoret Prona	Institucioni / Enti me pergjegjesi administrative	Institucioni / Enti perdoresh/juridik perdorimit	Te dhena te tjera (Shenime te veçanta)	
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	
779	3068 K-34-126-(179-B)	564	PF	Njesia Administrative Çlirim Bashkia Kolonje	22089		BUJQESI	Bashkia Kolonje	Bashkia Kolonje	Ne baze te matjeve ne terren per siperfaqen .	



PLAN RILEVIMI PËR PUNIME KADASTRALE																																									
PRONARI: SHTET		DATË 01/06/2021		QËLLIMI: KALIM PRONËSIE																																					
VENDNDODHJA BASHKIA KOLONJË DVASHK/ZVASHK KOLONJË ZONA KADASTRALE 3068 NUMËRI PASURISË 564 INDEX HARTE: K-34-126-(179-B) TË DHËNAT E PASURISË LLOJI PASURISË: PF [E PAFRYTSHME] SIP.PASURISË = 22,089.0 m² SIPËRFAQE GJURMËS NDËRTIMIT = [s'ka] m² NUMRI KATEVE = [s'ka] m² NUMRI PEMEVE [?]																																									
X=549625.778 Y=4477592.716 KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE X=550303.403 Y=4477592.716 SHPJEGUES PER NDARJE PASURIE: Parcela 564 = 22,089,7207 m² vijon Parcela [564]= 22,0897207 m² KUFIRI NDARËS KUFIRI SIPAS HARTES KADASTRALE — SIPËRFAQE = 22,089 m² KUFIRI SIPAS GJENDJES FAKTIKE — SIPËRFAQE = 22,089.7207 m²																																									
X=549625.778 Y=4477083.331 SH 1 : 2500 X=552984.99 Y=4441946.70																																									
<table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse; font-size: x-small;"> <thead> <tr> <th>Nr.</th> <th>ORIENTIMI</th> <th>PERDORIMI</th> <th>TIPI KUFIRIT</th> <th>KUFITARI</th> <th>ID/NIPT</th> <th>SHENIME TE REALIZUESIT</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>1</td> <td>Veriu</td> <td></td> <td>HK + PB</td> <td>Nr. pas.376; 373</td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>2</td> <td>Jugu</td> <td></td> <td>HK + PB</td> <td>Nr. pas.379</td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>3</td> <td>Lindje</td> <td></td> <td>HK + PB</td> <td>Nr. pas.396; 392</td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>4</td> <td>Perëndim</td> <td></td> <td>HK + PB</td> <td>Nr. pas. 356</td> <td></td> <td></td> </tr> </tbody> </table>							Nr.	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHENIME TE REALIZUESIT	1	Veriu		HK + PB	Nr. pas.376; 373			2	Jugu		HK + PB	Nr. pas.379			3	Lindje		HK + PB	Nr. pas.396; 392			4	Perëndim		HK + PB	Nr. pas. 356		
Nr.	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHENIME TE REALIZUESIT																																			
1	Veriu		HK + PB	Nr. pas.376; 373																																					
2	Jugu		HK + PB	Nr. pas.379																																					
3	Lindje		HK + PB	Nr. pas.396; 392																																					
4	Perëndim		HK + PB	Nr. pas. 356																																					
REALIZOI PER SUBJEKT PRIVAT EMRI: inxh. Muharem TARTARI LIÇENCA: NR. K.1601/1 DATE 19.12.2017 KOMPANIA/INSTITUCIONI: Bashkia Kolonjë NIPT: K48220001G NËNSHKRIMI/VULA REALIZOI PËR ASHK SPECIALISTI _____ DVASHK _____ NËNSHKRIMI _____ KONFIRMOI PERGJEGJESI/DREJTORI _____ NËNSHKRIMI / VULA _____ TEKNOLOGJIA E MATJEVE: T + D + O + Z Kode per teknologjine e matjeve: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash; PERCAKTIMI KUFIRIT: HK + PB Kode për përcaktimin e kufirit: P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale; SHENIME TE VECANTA: Pasuria nr. 564, Vol. _____, Fq. _____ është përditësuar sipas fragmentit të hartës të lëshuar nga ZVASHK Kolonjë. PRONARI/BASHKEPRONARET-DEKLARIM MBI MARREDHENIET ME KUFITARET EMRI _____ NËNSHKRIMI _____																																									
Kode për teknologjinë e matjeve dhe përcaktimi kufirit: T-Terren; Z-Zyrë; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash; P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale																																									



PLAN RILEVIMI PËR PUNIME KADASTRALE																																								
PRONARI: SHTET		DATA: 01/06/2021		QËLLIMI: TRASFERIM PRONËSIE																																				
VENDNDODHJA BASHKIA KOLONJË		DVASHK/ZVASHK KOLONJË		ZONA KADASTRALE 1412																																				
TË DHËNAT E PASURISË LLOJI PASURISË: PYLL		SIPASURISË = 316,800.0 m ²		SIPËRFAQE GJURMËS NDËRTIMIT = [S'KA] m ²																																				
		NUMËRI PASURISË 261/2/A		INDEX HARTE: K-34-126-(178-A) K-34-126-(178-C)																																				
		NUMËR NGASTRE Ek. Pjore 68c		NUMRI KATEVE [S'KA]																																				
				NUMRI PEMEVE [?]																																				
KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE																																								
X=544578.900 Y=4477845.352				X=547247.047 Y=4477845.352																																				
SH 1 : 10 000																																								
SHPIEGUES PËR NDARJE E TRASFERIM PASURIE: Parcela 261/2 = vijon Parcela 261/2/A= 316,800.0 m² 1,348,288.304 m² në Parcela 261/2/B= 1,031,488.3 m² KUFIRI SIPAS HA. KAD. pasuria 261/2 KUFIRI NDARËS KUFIRI SIPAS HARTES KADASTRALE Pasuria 261/2/A SIPËRFAQE = 316,800 m² KUFIRI SIPAS GIENDJES FAKTIVE Pasuria 261/2/A SIPËRFAQE = 316,800 m²																																								
<table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <thead> <tr> <th>Nr.</th> <th>ORIENTIMI</th> <th>PERDORIMI</th> <th>TIPI KUFIRIT</th> <th>KUFITARI</th> <th>ID/NIPT</th> <th>SHENIME TE REALIZUESIT</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>1</td> <td>Veriu</td> <td></td> <td>HK +PB</td> <td>Nr. pas. 54; 60</td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>2</td> <td>Jugu</td> <td></td> <td>HK +PB</td> <td>Nr. pas. 514</td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>3</td> <td>Lindje</td> <td></td> <td>HK +PB</td> <td>Nr. pas. 261/2/B</td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>4</td> <td>Perëndim</td> <td></td> <td>HK +PB</td> <td>Nr. pas. 13</td> <td></td> <td></td> </tr> </tbody> </table>						Nr.	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHENIME TE REALIZUESIT	1	Veriu		HK +PB	Nr. pas. 54; 60			2	Jugu		HK +PB	Nr. pas. 514			3	Lindje		HK +PB	Nr. pas. 261/2/B			4	Perëndim		HK +PB	Nr. pas. 13		
Nr.	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHENIME TE REALIZUESIT																																		
1	Veriu		HK +PB	Nr. pas. 54; 60																																				
2	Jugu		HK +PB	Nr. pas. 514																																				
3	Lindje		HK +PB	Nr. pas. 261/2/B																																				
4	Perëndim		HK +PB	Nr. pas. 13																																				
REALIZOI PËR SUBJEKT PRIVAT EMRI: inxh. Muharem TARTARI LIÇENCA: NR. K.1601/1 DATE 19.12.2019 KOMPANIA/INSTITUCIONI: INXHI MUHAREM TARTARI NIPT: K48220001G NËNSHKRIMI/VULA:			TEKNOLOGJIA E MATJEVE: T + D + O + Z Kode për teknologjinë e matjeve: T-Terren; Z-Zyrë; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash; PËRCAKTIMI KUFIRIT: HK + PB Kode për përcaktimin e kufirit: P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale; SHENIME TE VECANTA: Pasuria nr. 261/2, Vol. ___, Fq. ___, është përditësuar sipas fragmentit të hartës të lëshuar nga ZVASHK Kolonjë.																																					
REALIZOI PËR ASHK SPECIALISTI: _____ DVASHK: _____ NËNSHKRIMI: _____			KONFIRMOI PËRGJEGJËSI/DREJTORI: _____ NËNSHKRIMI / VULA:																																					
			PRONARI/BASHKËPRONARËT-DEKLARIM MBI MARRËDHENIET ME KUFITARËT EMRI: _____ NËNSHKRIMI: _____																																					
Kode për teknologjinë e matjeve dhe përcaktimi kufirit: T-Terren; Z-Zyrë; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash; P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale																																								



VENDIM
Nr. 118, datë 2.3.2022

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN
NR. 379, DATË 8.4.2009, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E
LISTËS PËRFUNDIMTARE TË
PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË
TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE
NË PËRDORIM TË BASHKISË
LESKOVIK, TË QARKUT TË KORÇËS”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 5, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 379, datë 8.4.2009, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) në titullin dhe në përmbajtjen e vendimit, fjalët “Bashkia Leskovik” zëvendësohen me “Njësia Administrative Leskovik, Bashkia Kolonjë”;

b) në listën e inventarit shtohet një pjesë e pasurisë 763/10/2, me sipërfaqe 36 837.2 (tridhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e tridhjetë e shtatë pikë dy) m², e llojit “kullotë”, me vendndodhje në zonën kadastrale 2430, sipas formularit, gjithsej 1 (një) fletë, dhe planeve të rilevimit, që i bashkëlidhen këtij vendimi;

c) në lidhjen 1, bashkëlidhur vendimit, pasuria e përcaktuar në shkronjën “b” transferohet në pronësi të Bashkisë Kolonjë, për Njësine Administrative Leskovik, në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit.

2. Ngarkohen Bashkia Kolonjë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE
(Per inventarizimin e pronave te veçanta)

Bashkia Kolonjë				Identifikoi: Erjon Cenko Specialist I DPKZHT Ganiart Eminaj Specialist I DPKZHT		Supervizoi: Muharem Tartari Drejtore I DPKZHT		Aprovoi: Erion Isai (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel., firma, vulë)		Kryetari I Bashkisë	
Fusha e përdorimit të Pronës: Bujqësi											
Nr. Rend.	Zona Kadastr. & Indeksi i Hartes	Nr. Pasurisë	Lloji i Pronës	Emri i Pronës Adresa	Sip. Totale e Pronës (m ²)	Nga Sip. Totale: Sa Nderetese (m ²)	Funksioni për të cilin përdoret Prona	Institucioni / Enti me përgjegjësi administrative	Institucioni / Enti përdorues Statusi juridik i përdorimit	Te dhena të tjera (Shenime të veçanta)	
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	
421	2430 K-34-138-(181-B)	763/10/2	Kullote	Njësia Administrative Leskovik Bashkia Kolonjë	36837.2		Bujqësi	Bashkia Kolonjë	Bashkia Kolonjë	Sipërfaqja që i transferohet Bashkisë Kolonjë është 36837.2 e cila është pjesë e pasurisë me nr 763/10/2	



PLAN RILEVIMI PËR PUNIME KADASTRALE					
PRONARI: SHTET		DATË 01/06/2021		QËLLIMI: TRASFERIM PRONËSIE	
VENDNDODHJA BASHKIA KOLONJË DVASHK/ZVASHK KOLONJË ZONA KADASTRALE 2430 NUMËRI PASURISË 763/10/2 [B] INDEX HARTE: K-34-138-[181-B]					
TË DHËNAT E PASURISË LLOJI PASURISË: KULLOTË SIP. PASURISË = 36,837.1627 m ² SIPËRFAQE GJURMËS NDËRTIMIT = [S'KA] m ² NUMRI KATEVE [S'KA] NUMRI PEMEVE [?]					
KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE					
SHPJEGUES PER NDARJE PASURIE: Parcela 763/10/2 = 48,766.7005 m² vijon Parcela [A] = 11,929.5378 m² Parcela [B] = 36,837.1627 m² KUFIRI NDARËS KUFIRI SIPAS HARTËS KADASTRALE KUFIRI SIPAS GJËNDJES FAKTIKE					
SH 1 : 2500					
Nr.	ORIENTIMI	PËRDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT
1	Veriu	Tokë Arë	HK + PB	Nr. pas.3992; 761/2;761/3;761/4	
2	Jugu	Kullotë	HK + PB	Nr. pas.763/10/1; 3992	
3	Lindje	Pyll + Kullotë	HK + PB	Nr. pas.763/10/1; 3992	
4	Perëndim	T. Arë + Kullotë	HK + PB	Nr. pas.763/10/2 [A]; 3992	
					SHËNIME TE REALIZUESIT
					Toka të ndara me AMTP-ë
					Vendim i KKK të ish-pronarve nr. 49 [XHOMO]
					Toka të ndara me AMTP-ë
					ish-Posta Kufitare SARANDAPOR
REALIZOI PER SUBJEKT PRIVAT EMRI: Ing. Muharrem TARTARI LICËNCË: 11/12/2017 KOMETA: 11/12/2017 NIPT: K48220001G NËNSHKRIMI/VULA:					
REALIZOI PËR ASHK SPECIALISTI: _____ DVASHK: _____ NËNSHKRIMI: _____ KONFIRMOI PËRGJEGJËS/DREJTORI: _____ NËNSHKRIMI / VULA:					
TEKNOLOGJIA E MATJEVE: T + D + O + Z Kode për teknologjinë e matjeve: T-Terren; Z-Zyrë; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash PËRCAKTIMI KUFIRIT: HK + PB Kode për përcaktimin e kufirit: P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale SHËNIME TË VECANTA: Pasuria nr. 763/10/2, Vol. ____, Fq. ____ është përditësuar sipas fragmentit të hartës të lëshuar nga ZVASHK Kolonjë. PRONARI/BASHKEPRONARET-DEKLARIM MBI MARREDHENIET ME KUFITARET EMRI: _____ NËNSHKRIMI: _____					
Kode për teknologjinë e matjeve dhe përcaktimi kufirit: T-Terren; Z-Zyrë; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash; P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale					



PLAN RILEVIMI PËR PUNIME KADASTRALE						
PRONARI: SHTET		DATË 01/06/2021		QËLLIMI: TRASFERIM PRONËSIE		
VENDNDODHJA		DVASHK/ZVASHK KOLONJË		ZONA KADASTRALE 2430		
BASHKIA KOLONJË		NUMËRI PASURISË 763/10/2 [B]		INDEX HARTE: K-34-138 (181-B)		
TË DHËNAT E PASURISË		SIPASURISË = 36,837.1627 m²		SIPËRFAQE GJURMËS NDËRTIMIT = [S KA] m²		
LLOJI PASURISË: KULLOTË		NUMRI KATEVE [S KA]		NUMRI PEMEVE [?]		
KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE						
SHPIJEGUES PER NDARJE PASURIE: Parcela 763/10/2 = 48,766.7005 m² vijon Parcela [A]= 11,929.5378 m² Parcela [B]= 36,837.1627 m² KUFIRI NDARËS KUFIRI SIPAS HARTËS KADASTRALE KUFIRI SIPAS GJËNDJES FAKTIKE						
SH 1 : 2500						
Nr.	ORIENTIMI	PËRDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHËNIME TE REALIZUESIT
1	Veriu	Tokë Arë	HK + PB	Nr. pas.3992; 761/2;761/3;761/4		Toka të ndara me AMTP-ë
2	Jugu	Kullotë	HK + PB	Nr. pas.763/10/1; 3992		Vendim i KKK të ish-pronarve nr. 49 [XHOMO]
3	Lindje	Pyll + Kullotë	HK + PB	Nr. pas.763/10/1; 3992		Toka të ndara me AMTP-ë
4	Perëndim	T. Arë + Kullotë	HK + PB	Nr. pas.763/10/2 [A]; 3992		ish-Posta Kufitare SARANDAPOR
REALIZOI PER SUBJEKT PRIVAT			TEKNOLOGJIA E MATJEVE: T + D + O + Z			
EMRI MUKAMET TARTARI PROJEKTIM: JB/KAYB/15 LIC NX2580/1 K160/11 KOMPANIA/INSTITUCIONE: Bashkia Kolonjë NIPT: K48220001G NËNSHKRIMI/VULA REALIZOI PËR ASHK SPECIALISTI DVASHK NËNSHKRIMI KONFIRMOI PËRGJEGJËS/DREJTORI NËNSHKRIMI / VULA			Kode për teknologjinë e matjeve: T-Terren; Z-Zyrë; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash PËRCAKTIMI KUFIRIT: HK + PB Kode për përcaktimin e kufirit: P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale SHËNIME TË VECANTA: Pasuria nr. 763/10/2, Vol. __, Fq. __ është përditësuar sipas fragmentit të hartës të lëshuar nga ZVASHK Kolonjë. PRONARI/BASHKEPRONARET-DEKLARIM MBI MARREDHENIET ME KUFITARET EMRI NËNSHKRIMI			
Kode për teknologjinë e matjeve dhe përcaktimi kufirit: T-Terren; Z-Zyrë; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash; P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale						



VENDIM
Nr. 119, datë 2.3.2022

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 82, DATË 31.1.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPALLJEN E ZONËS SË RE PËR ZHVILLIM NË NJËSINË ADMINISTRATIVE BALDUSHK, BASHKIA TIRANË, DHE CAKTIMIN E BASHKISË TIRANË SI NJËSI ZBATUESE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13, shkronja “b”, nënndarjet “iii” e “iv”, dhe 16, pika 3, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Shtetit për

Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Këshilli i Ministrave


VENDOSI:

1. Harta dhe koordinatat, që i bashkëlidhen vendimit nr. 82, datë 31.1.2020, të Këshillit të Ministrave, ndryshohen, përkatësisht, me hartën dhe koordinatat bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohen zëvendëskryeministri dhe ministri i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



**VENDIM****Nr. 121, datë 2.3.2022****PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË
RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E
RIKONSTRUKSIONIT TË NJËSIVE
INDIVIDUALE TË BANIMIT DHE
NJËSIVE TË BANIMIT NË NDËRTESA
(PALLAT), NË BASHKITË TIRANË
DHE RROGOZHINË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, 25 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; dhe të nenit 7, të ligjit nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën 434 055 000 (katërqind e tridhjetë e katër milionë e pesëdhjetë e pesë mijë) lekë, për financimin e rikonstruksionit të njësive individuale të banimit dhe njësive të banimit në ndërtesa (pallat), për ato individë, të cilët përfitojnë nga grantet e rikonstruksionit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte të dëmtuara rëndë apo të dëmtuara lehtë, si pasojë e fatkeqësisë natyrore dhe që nuk duhen rindërtuar nga e para, por kanë nevojë për punime rikonstruksioni ose riparime, në bashkitë Tiranë dhe Rrogozhinë, sipas detajimit, si më poshtë vijon:

a) Bashkisë Tiranë i transferohet fondi në masën 257 705 000 (dyqind e pesëdhjetë e shtatë milionë e shtatëqind e pesë mijë) lekë pa TVSH;

b) Bashkisë Rrogozhinë i transferohet fondi në masën 176 350 000 (njëqind e shtatëdhjetë e gjashtë milionë e treqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa TVSH.

2. Efekti financiar do të përballohet nga pjesa e financuar nga shpenzimet e fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2022, dhe u transferohet bashkive Tiranë dhe Rrogozhinë në formën e transfertës së pakushtëzuar, për financimin e

rikonstruksionit të banesave individuale dhe njësi banimi në ndërtesa (pallat) për ata individë, të cilët përfitojnë nga grantet e rikonstruksionit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte të dëmtuara rëndë apo të dëmtuara lehtë, si pasojë e fatkeqësisë natyrore dhe që nuk duhen rindërtuar nga e para, por kanë nevojë për punime rikonstruksioni ose riparime.

3. Ngarkohen zëvendëskryeministri dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe bashkitë Tiranë e Rrogozhinë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR**Edi Rama****VENDIM****Nr. 122, datë 2.3.2022****PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË
RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E
RINDËRTIMIT, MBIKËQYRJES DHE
KOLAUDIMIT TË SHKOLLËS 9-VJEÇARE
“PICAR”, BASHKIA VORË, DHE
CAKTIMIN E BASHKISË VORË SI NJËSI
ZBATUESE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 13, shkronja “b”, nënndarjet “i” e “iii”, 16, e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; dhe të nenit 7, të ligjit nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të shkollës 9-vjeçare “Picar”, Bashkia Vorë, në masën 139 613 966.96 (njëqind e tridhjetë e nëntë milionë e gjashtëqind e trembëdhjetë mijë e



nëntëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë pikë nëntëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.

2. Bashkisë Vorë, në buxhetin e vitit 2022, i transferohet fondi në formën e transfertës së pakushtëzuar, në masën 27 922 793 (njëzet e shtatë milionë e nëntëqind e njëzet e dy mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e tre) lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit, mbikëqyrjes dhe të kolaudimit të shkollës 9-vjeçare “Picar”, Bashkia Vorë, i cili do të përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2022.

3. Caktimin e Bashkisë Vorë si njësi zbatuese, për financimin e rindërtimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të shkollës 9-vjeçare “Picar”, Bashkia Vorë, sipas pikave 1 dhe 2, të këtij vendimi.

4. Ngarkohen zëvendëskryeministri dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Vorë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM

Nr. 124, datë 2.3.2022

PËR PËRCAKTIMIN E AFATIT TË HYRJES DHE QËNDRIMIT TË SHTETASVE TË SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 29, të ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe të ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shtetasit e Shteteve të Bashkuara të Amerikës kanë të drejtë të hyjnë dhe të qëndrojnë pa leje qëndrimi në Republikën e Shqipërisë për një afat deri në një vit.

2. Këta shtetas mund të rihyjnë dhe të qëndrojnë pa leje qëndrimi në Republikën e Shqipërisë për një afat të ri deri në një vit, nëse kanë qëndruar më shumë se 90 ditë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

3. Ngarkohen Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM

Nr. 125, datë 2.3.2022

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 420, DATË 8.6.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E CEREMONIALIT SHTETËROR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 17, të ligjit nr. 23/2015, “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 420, datë 8.6.2016, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Në kapitullin VII, titulli i pikës 5 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Pajisja me targa CD, TR dhe HCC (të gjelbra)”.

2. Pika 5.8, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“5.8 Konsujt e nderit, të emëruar në Republikën e Shqipërisë, kanë të drejtë të përdorin për qëllime pune, në funksion të pozicionit të tyre, jo më shumë se një automjet personal me targa, me inicialet dalluese “HCC”, automjet i cili përjashtohet nga detyrimet doganore dhe TVSH-ja, të zbatuara në shitblerjen e automjeteve në Republikën e Shqipërisë.”.

3. Në pikën 5.19, fjalët “... ose HCC e zakonshme (në rastin e konsujve të nderit) ...” zëvendësohen me “... ose HCC...”.

4. Në pikën 5.24, në paragrafin e dytë, fjalët “... shenjën dalluese HCC...” zëvendësohen me “... targën HCC...”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama
Faqe | 4177

**VENDIM****Nr. 127, datë 2.3.2022**

**PËR KARAKTERISTIKAT GRUPORE,
LLOJET DHE PARAMETRAT TEKNIKË
TË ARMËVE TË FTOHTA, PËR TË CILAT
ORGANI KOMPETENT LËSHON
AUTORIZIM PËR MBAJTJEN
NGA SHTETASIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të pikës 1, të nenit 37, të ligjit nr. 152/2020, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 74/2014, “Për armët”, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Armët e ftohta janë armët e kategorisë “D3”, të cilat përkufizohen si armë të ndryshme nga ajo e zjarrit ose e qitjes dhe çdo lloj instrumenti i përgatitur dhe i destinuar posaçërisht për sulm kundër personave ose për vetëmbrojtje. Ato mund të jenë me majë e teh, si: shpatat, shkopinjë-shpata, kamat, pinjallët, bajonetat, thikat, thikat me shkrepje dhe të ngjashme me to, si dhe armë mprehëse ose me kontakt, si: shkopinjë e gomës, topuzët, dorezat metalike, trulllosësit elektrikë dhe të ngjashëm me to.

2. Karakteristikat e armëve të ftohta, që mund të mbahen në vendbanim, për të cilat lëshohet autorizim nga Policia e Shtetit, janë:

a) Armët e ftohta me teh prerës shpues, të përbërë prej materiali të fortë dhe që kanë fortësi të konsiderueshme në të gjithë konstruksionin e tyre, aftësi shpuese e goditëse ndaj objekteve që ndeshet, janë të pajisura me teh apo dorezë, edhe një element tjetër, kufizuesin, i cili vendoset midis tehut dhe dorezës, me parametrat si më poshtë:

i. armët me gjatësi të tehut më shumë se 11 (njëmbëdhjetë) cm, gjerësi më shumë se 2 (dy) cm dhe trashësi afër dorezës më shumë se 0.25 (zero pikë njëzet e pesë) cm dhe që nuk kanë destinacion tjetër përdorimi;

ii. armët, tehu i të cilave është i mprehtë, ku spikat qartë maja luftarake apo elementë të tjerë si, skarpate, shkallëzime, kanale gjatësore etj., analogë me ato të thikave të fabrikuarat të gjahut, kamave dhe armëve të tjera të ftohta me teh;

iii. armët, doreza e të cilave ka formë të përshtatshme për t’u mbajtur në dorë, me gjatësi më shumë se 9.5 (nëntë pikë pesë) cm dhe gjerësi ose diametër më shumë se 2 (dy) cm;

b) Thikat e gjuetisë dhe thikat ushtarake me stampat e logot përkatëse, që nuk kanë destinacion tjetër dhe që plotësojnë kriteret teknike, të përcaktuara në shkronjën “a”, të pikës 2, të këtij vendimi.

c) Armët e ftohta pa teh dërmues goditës, të pajisura me pjesë të posaçme goditëse, kërbaç, topuz, elementë të domosdoshëm të armës së ftohtë dërmuese, me dhëmbëza në sipërfaqen goditëse, me përshtatshmëri dhe ndërtim për të shkaktuar goditje, pa vetëdëmtuar dorën, me parametrat si më poshtë:

i. armët, përforcueset e grushtit e mbi pëllëmbëzat e përgatitura prej metali, me peshë më shumë se 120-150 (njëqind e njëzet deri në njëqind e pesëdhjetë) gram ose pak më të lehta në peshë, por që janë solide në konstrukt dhe kanë gunga të theksuara dhe ruajnë mirë cilësitë luftarake të armës së ftohtë dërmuese;

ii. armët, për të cilat pesha e pjesës së kërbachit të bërë vetë arrin 200-400 (dyqind deri në katërqind) gram, pesha e pjesës rrahëse të topuzit, 600-800 (gjashtëqind deri në tetëqind) gram e më tepër.

3. Policia Shtetit lëshon autorizimin për mbajtjen e armëve të ftohta ndaj subjekteve, që plotësojnë kriteret e përcaktuara në ligjin nr. 74/2014, “Për armët”, të ndryshuar.

4. Ngarkohet Ministria e Brendshme dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**



VENDIM

Nr. 128, datë 2.3.2022

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË VENDIMIN NR. 953, DATË 29.12.2014,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
DISPOZITAT ZBATUESE TË LIGJIT NR.
92/2014, ‘PËR TATIMIN MBI VLERËN E
SHTUAR NË REPUBLIKËN E
SHQIPËRISË’, TË NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 159, të ligjit nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 953, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 8 bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

1. Në pikat 1, shkronja “a”, 3, paragrafi i dytë, 4.1, shkronjat “b” e “c”, fjalët “50 milionë (pesëdhjetë milionë) lekë”, “50 milionë lekë”, “50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekë” zëvendësohen me “500 000 000 (pesëqind milionë) lekë”.

2. Shkronja “ç”, e pikës 1, dhe pika 4.4 shfuqizohen.

Neni 2

Pika 1, e nenit 8/1, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Në zbatim të pikës 10, të nenit 49, të ligjit, furnizimi i inputeve bujqësore, siç janë plehrat kimike, pesticidet, farat dhe fidanët, përveç hormoneve të klasifikuara në kodet 2937 të NKM-së, është furnizim me normë të reduktuar të tatimit mbi vlerën e shtuar 10 (dhjetë) për qind.

Lista e kategorive të inputeve bujqësore është e përcaktuar në aneksin 4, që i bashkëlidhet këtij vendimi.”.

Neni 3

Pas pikës 1, të nenit 11, shtohet pika 2, me këtë përmbajtje:

“2. Për personat e tatueshëm, që ofrojnë shërbime në veprimtari ekonomike, sipas profesioneve të tilla, si: noter, përmbarues gjyqësor shtetëror dhe privat, kufiri minimal i regjistrimit për TVSH-në është zero, pavarësisht nga qarkullimi vjetor i tyre. Të gjithë këta janë persona të tatueshëm, të regjistruar për TVSH-në, edhe nëse kryejnë veprimtari të përjashtuara sipas ligjit.”.

Neni 4

Në anekset 1.1 dhe 3, bashkëlidhur vendimit, fjalët “50 milionë (pesëdhjetë milionë) lekë” dhe “50 MILIONË LEKË” zëvendësohen me “500 000 000 (pesëqind milionë) lekë”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe neni 2 i shtrin efektet nga data 5 janar 2022.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

UDHËZIM I PËRBASHKËT

Nr. 4, datë 31.1.2022

**PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE,
KUSHTEVE DHE PROCEDURAVE MBI
PËRJASHTIMIN NGA TAKSAT PËR
QUMËSHTIN PLUHUR, PËR HIRRË
QUMËSHTI DHE KREM QUMËSHTI TË
FABRIKAVE TË PRODHIMIT DHE
PËRPUNIMIT TË QUMËSHTIT DHE
NËNPRODUKTEVE TË TIJ**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të paragrafit 8, të nenit 9, të ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar, ministri i Financave dhe Ekonomisë dhe ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

UDHËZOJNË:

Qëllimi i këtij udhëzimi është të përcaktojë kriteret, kushtet dhe procedurat e përjashtimit nga pagimi i taksës kombëtare për qumështin pluhur, hirrën e qumështit dhe kremin e qumështit, në rastet kur ato përdoren apo prodhohen nga fabrikat e prodhimit dhe përpunimit të qumështit dhe nënprodukteve të tij.



1. Kriteret, kushtet dhe procedurat e përjashtimit nga pagimi i taksës kombëtare për qumështin pluhur:

a) Subjektet e prodhimit dhe përpunimit të qumështit dhe nënprodukteve të tij, bazuar në paragrafin 8, të nenit 9, të ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare”, janë të përjashtuara nga pagimi i taksës kombëtare të qumështit pluhur në import apo blerjen e tij brenda vendit;

b) Subjektet e prodhimit dhe përpunimit të qumështit dhe nënprodukteve të tij, të cilat përdorin qumështin pluhur në procesin e prodhimit të nënprodukteve, duhet të kenë kartën teknologjike të produkteve që kontrollohet nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, sipas legjislacionit në fuqi;

c) Subjektet e prodhimit dhe përpunimit të qumështit dhe nënprodukteve të tij përjashtohen nga pagimi i taksës kombëtare të qumështit pluhur nëse, për produktet që prodhojnë dhe tregtojnë, në etiketën e produktit të notifikuar dhe aprovuar sipas rregullave në fuqi nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, kanë të pasqyruar përmbajtjen në përqindje të qumështit pluhur në produktin e gatshëm që tregtohet;

d) Të gjitha subjektet e tjera tregtare, të cilët nuk janë përpunues të qumështit dhe prodhues të nënprodukteve të tij, paguajnë taksën kombëtare të qumështit pluhur në rastet e importit apo të blerjes brenda vendit nga prodhues potencialë të qumështit pluhur;

e) Për t'u përjashtuar nga pagimi i taksës kombëtare të qumështit pluhur në import, fabrikat e prodhimit dhe përpunimit të qumështit dhe nënprodukteve të tij pajisen me autorizim nga drejtoria rajonale e tatimeve, në lidhje me veprimtarinë që ata ushtrojnë në fushën e përpunimit të qumështit dhe prodhimit e tregutit të nënprodukteve të tij, si: qumësht i inbotiluar, gjalpë, gjizë, kos, dhallë, hurrë etj. Subjektet e tjera tregtare, të cilat mund të përdorin qumështin si lëndë të parë për prodhimin e produkteve të tyre, nuk pajisen me autorizim;

f) Për t'u pajisur me autorizim, subjektet e prodhimit dhe përpunimit të qumështit dhe nënprodukteve të tij duhet të paraqesin në drejtorinë rajonale tatimore dokumentacionin në lidhje me kartën teknologjike apo aktet e tjera të notifikimit dhe aprovimit të etiketave të prodhimit

nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, sipas kërkesave të parashikuara në legjislacionin e fushës;

g) Autorizimi i lëshuar nga drejtoria rajonale e tatimeve depozitohet në strukturat përkatëse të administratës doganore, e cila lejon mospagimin e taksës së qumështit pluhur për kategorinë e subjekteve të pajisura me vërtetim nga administrata tatimore;

h) Subjektet e prodhimit dhe përpunimit të qumështit dhe nënprodukteve të tij, të cilët janë pajisur me autorizim nga administrata tatimore dhe kanë importuar/blerë brenda vendit qumësht pluhur duke mos paguar taksën kombëtare të qumështit pluhur, janë të detyruar që në etiketën e çdo produkti që hedhin në treg të pasqyrojnë përmbajtjen e sasisë në përqindje të qumështit pluhur në produktin e gatshëm;

i) Në fund të çdo viti kalendarik, brenda muajit janar të vitit pasardhës, subjektet e prodhimit dhe përpunimit të qumështit dhe nënprodukteve të tij deklarojnë në drejtorinë rajonale tatimore:

i. sasinë e qumështit pluhur të importuar/blerë brenda vendit pa paguar taksën e qumështit pluhur të trashëguar gjendje nga viti i kaluar;

ii. sasinë e qumështit pluhur të importuar/blerë brenda vendit pa paguar taksën e qumështit pluhur gjatë vitit raportues;

iii. sasinë e qumështit pluhur të importuar/blerë brenda vendit pa paguar taksën e qumështit pluhur gjendje në fund të vitit raportues;

iv. sasinë e qumështit pluhur të importuar/blerë brenda vendit pa paguar taksën e qumështit pluhur të përdorur në vitin raportues (i+ii-iii);

v. sasinë e prodhuar të nënprodukteve sipas strukturës ku është përdorur qumështi pluhur, sipas përqindjes së deklaruar në etiketë;

vi. krahasimi i sasisë së qumështit pluhur të konsumuar, sipas paragrafit “iv”, me sasinë e qumështit pluhur të përdorur sipas normativave dhe sasive të prodhimit të deklaruar, sipas paragrafit “v”;

vii. në rastet kur sasia e qumështit pluhur të konsumuar, për të cilin nuk është paguar taksa sipas paragrafit “iv”, është më e lartë se sasia e qumështit pluhur të përdorur sipas normativave dhe sasive të prodhimit të deklaruar sipas paragrafit “v”, për këtë diferencë subjekti raportues deklaron dhe paguan në drejtorinë rajonale të tatimeve taksën e papaguar (diferenca në sasi x 100 lekë/kg);



viii. administrata tatimore verifikon saktësinë e llogaritjeve sipas raportimit dhe kryen kontrollë dhe verifikime bazuar në procedurat e njohura të kontrollit.

2. Kriteret, kushtet dhe procedurat e përjashtimit nga pagimi i taksës kombëtare për hirrën e qumështit dhe kremin e qumështit, në rastet kur ato prodhohen nga fabrikat e prodhimit dhe përpunimit të qumështit dhe nënprodukteve të tij:

a) Subjektet e prodhimit dhe përpunimit të qumështit dhe nënprodukteve të tij, bazuar në paragrafin 8, të nenit 9, të ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare”, janë të përjashtuara nga pagimi i taksës kombëtare për prodhimin e hirrës së qumështit dhe kremit të qumështit;

b) Subjektet e prodhimit dhe përpunimit të qumështit dhe nënprodukteve të tij, duhet të kenë kartën teknologjike të produkteve që kontrollohet nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, sipas legjislacionit në fuqi;

c) Subjektet e prodhimit dhe përpunimit të qumështit dhe nënprodukteve të tij përjashtohen nga pagimi i taksës kombëtare për prodhimin e hirrës së qumështit dhe kremit të qumështit nëse, për produktet që prodhojnë dhe tregtojnë, në etiketën e produktit të notifikuar dhe aprovuar sipas rregullave në fuqi nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, kanë të pasqyruar përmbajtjen në përqindje të produkteve të përdorura në produktin e gatshëm që tregtohet;

d) Të gjitha subjektet e tjera tregtare, të cilët nuk janë përpunues të qumështit dhe prodhues të nënprodukteve të tij, paguajnë taksën kombëtare për hirrën e qumështit dhe kremin e qumështit, sipas dispozitave të ligjit “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar.

3. Ngarkohet me zbatimin e këtij udhëzimi Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE
DHE EKONOMISË

Delina Ibrahimaj

MINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL

Frida Krifca

VENDIM

Nr. 3, datë 25.2.2022

BIBLIOGRAFIA E INFORMACIONIT TË DEKLASIFIKUAR NË AIDSSH

Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.2.1999, “Për informacionin e klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”, të ndryshuar, në kreun III, neni 13, pika “b”; në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 662, datë 15.11.2017, “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”, kreu II, neni 4, pikat “a”, “c”; dhe në udhëzimin nr. 99, datë 13.4.2018, “Për zbatimin e vendimit nr. 662, datë 15.11.2017, për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”, Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “Sekret shtetëror”, në AIDSSH, i ngritur me urdhrin nr. 13, datë 3.5.2018 të kryetarit të Autoritetit “Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”, të ndryshuar në AIDSSH”, ka bërë deklasifikimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, me vendimin nr. 3, datë 25.2.2022, si më poshtë:

I. Deklasifikoi plotësisht informacionet e mëposhtme:

1. Fashikull emigranti nr. 4664, në ngarkim të R.M., me 51 (pesëdhjetë e një) fletë, ndër të cilat 1 (një) fletë është e klasifikuar me nivelin e klasifikimit “Tepër sekret” dhe 2 (dy) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket fondit Operativ.

2. Dosje formulare nr. 4664, në ngarkim të R.M., me 13 (trembëdhjetë) fletë, ndër të cilat 1 (një) fletë është e klasifikuar me nivelin e klasifikimit “Tepër sekret”. Dosja i përket fondit Operativ.

3. Fashikull nr. 368, në ngarkim të K.N. me 12 (dymbëdhjetë) fletë, ndër të cilat 1 (një) fletë është e klasifikuar me nivelin e klasifikimit “Tepër sekret” dhe 5 (pesë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket fondit Dega e Punëve të Brendshme Lezhë.

4. Dosje personale nr. 28, “Gramozi”, me 46 (dyzet e gjashtë) fletë, ndër të cilat 12 (dymbëdhjetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Tepër sekret” dhe 2 (dy) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”.



Dosja i përket fondit Dega e Punëve të Brendshme Mirditë.

5. Dosje pune nr. 28, “Gramozi”, me 166 (njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) fletë, ndër të cilat 3 (tri) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Tepër sekret”. Dosja i përket fondit Dega e Punëve të Brendshme Mirditë.

6. Dosje personale nr. 1, “Tomorri”, me 90 (nëntëdhjetë) fletë, ndër të cilat 15 (pesëmbëdhjetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret” dhe 9 (nëntë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Tepër sekret”. Dosja i përket fondit Dega e Punëve të Brendshme Mirditë.

7. Dosje pune nr. 1/1, “Tomorri”, me 149 (njëqind e dyzet e nëntë) fletë, ndër të cilat 8 (tetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret” dhe 1 (një) fletë është e klasifikuar me nivelin e klasifikimit “Tepër sekret”. Dosja i përket fondit Dega e Punëve të Brendshme Mirditë.

8. Dosje pune nr. 1184/1, “Klubi”, me 32 (tridhjetë e dy) fletë, ndër të cilat 5 pesë fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Dega e Punëve të Brendshme Mirditë.

9. Dosje personale nr. 1184, “Klubi”, me 84 (tetëdhjetë e katër) fletë, ndër të cilat 13 (trembëdhjetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret” dhe 7 (shtatë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Tepër Sekret”. Dosja i përket Fondit Dega e Punëve të Brendshme Mirditë.

10. Dosje personale nr. 1734, “Tërmeti”, me 27 (njëzet e shtatë) fletë, ndër të cilat 8 (tetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret” dhe 4 (katër) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Tepër sekret”. Dosja i përket Fondit Dega e Punëve të Brendshme Mirditë.

11. Dosje pune nr. 1734/1, “Tërmeti”, me 16 (gjashtëmbëdhjetë) fletë, ndër të cilat 1 (një) fletë është e klasifikuar me nivelin e klasifikimit “Sekret” dhe 1 (një) fletë është e klasifikuar me nivelin e klasifikimit “Tepër sekret”. Dosja i përket Fondit Dega e Punëve të Brendshme Mirditë.

12. Dosje pune nr. 1734/2, “Tërmeti”, me 34 (tridhjetë e katër) fletë, ndër të cilat 1 (një) fletë është e klasifikuar me nivelin e klasifikimit “Sekret” dhe 1 (një) fletë është e klasifikuar me nivelin e klasifikimit “Tepër sekret”. Dosja i përket Fondit Dega e Punëve të Brendshme Mirditë.

13. Dosje personale nr. 168, “Drini”, me 23 (njëzet e tre) fletë, ndër të cilat 17 (shtatëmbëdhjetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Tepër sekret”. Dosja i përket Fondit Dega e Punëve të Brendshme Mirditë.

14. Evidencë agenturale operative e punëtorit operativ, ekzemplar nr. 7, me 283 (dyqind e tetëdhjetë e tre) fletë, me nivel klasifikimi “Sekret”. Libri i përket fondit Dega e Punëve të Brendshme Fier.

KRYETARE
Gentiana Sula

VENDIM
Nr. 4, datë 25.2.2022

**BIBLIOGRAFIA E INFORMACIONIT TË
DEKLASIFIKUAR NË AIDSSH**

Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.2.1999, “Për informacionin e klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”, të ndryshuar, kreu III, neni 13, pika “b”; në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 662, datë 15.11.2017, “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”, kreu II, neni 4, pikat “a”, “c”; dhe në udhëzimin nr. 99, datë 13.4.2018, “Për zbatimin e vendimit nr. 662, datë 15.11.2017, për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”, Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “Sekret shtetëror”, në AIDSSH, i ngritur me urdhrin nr. 13, datë 3.5.2018 të kryetarit të Autoritetit, “Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”, të ndryshuar në AIDSSH”, ka bërë deklasifikimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, me vendimin nr. 4, datë 25.2.2022, si më poshtë:

I. Deklasifikoi plotësisht informacionet e mëposhtme:

1. Evidenca agenturalo-operative e punëtorit operativ nr. 001, me 110 (njëqind e dhjetë) fletë, me nivel klasifikimi “Tepër sekret”. Evidenca i përket fondit Dega e Punëve të Brendshme Fier.

2. Dosje personale nr. 1743, në ngarkim të N.K., me 33 (tridhjetë e tre) fletë, ndër të cilat 5 (pesë) fletë kanë nivelin e klasifikimit “Tepër sekret” dhe 1 (një) fletë ka nivelin e klasifikimit



“Sekret”. Dosja i përket fondit Dega e Punëve të Brendshme Mat.

3. Dosje pune nr. 1743, në ngarkim të N.K., me 69 (gjashtëdhjetë e nëntë) fletë, ndër të cilat 2 (dy) fletë kanë nivelin e klasifikimit “Tepër sekret” dhe 4 (katër) fletë kanë nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket fondit Dega e Punëve të Brendshme Mat.

4. Dosje formulare nr. 2918, në ngarkim të SH.K., me 2(dy) volume me 90 (nëntëdhjetë) fletë dhe 88 (tetëdhjetë e tetë) fletë, ndër të cilat 8 (tetë) fletë kanë nivelin e klasifikimit “Tepër sekret” dhe 59 (pesëdhjetë e nëntë) fletë kanë nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Dega e Punëve të Brendshme Elbasan.

5. Dosje personale nr. 4717, në ngarkim të N.P., me 38 (tridhjetë e tetë) fletë, ndër të cilat 8 (tetë) fletë kanë nivelin e klasifikimit “Tepër sekret” dhe 10 (dhjetë) fletë kanë nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket fondit Dega e Punëve të Brendshme Kavajë.

6. Dosje pune nr. 4717, në ngarkim të N.P., me 73 (shtatëdhjetë e tre) fletë, ndër të cilat 1 (një) fletë ka nivelin e klasifikimit “Tepër sekret” dhe 3 (tre) fletë kanë nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket fondit Dega e Punëve të Brendshme Kavajë.

7. Dosje përpunimi nr. 4895, në ngarkim të S.M., me 110 (njëqind e dhjetë) fletë, ndër të cilat 10 (dhjetë) fletë kanë nivelin e klasifikimit “Tepër sekret” dhe 14 (katërmëdhjetë) fletë kanë nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket fondit Dega e Punëve të Brendshme Elbasan.

8. Dosje personale nr. 11, në ngarkim të P.L.L., me 136 (njëqind e tridhjetë e gjashtë) fletë, ndër të cilat 19 (nëntëmbëdhjetë) fletë kanë nivelin e klasifikimit “Tepër sekret” dhe 25 (njëzet e pesë) fletë kanë nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket fondit Dega e Punëve të Brendshme Mirditë.

9. Dosje pune nr. 11, në ngarkim të P.L.L., me 3 (tri) vëllime. Vëllimi i parë ka 409 (katërqind e nëntë) fletë, ndër të cilat 3 (tri) fletë kanë nivelin e klasifikimit “Tepër sekret”. Vëllimi i dytë ka 389 (treqind e tetëdhjetë e nëntë) fletë, ndër të cilat 2 (dy) fletë kanë nivelin e klasifikimit “Tepër sekret” dhe 5 (pesë) fletë kanë nivelin e klasifikimit “Sekret”. Vëllimi i tretë ka 110 (njëqind e dhjetë) fletë, ndër të cilat 5 (pesë) fletë kanë nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i

përket fondit Dega e Punëve të Brendshme Mirditë.

10. Dosje përpunimi nr. 1679, në ngarkim të B.B., me 2 (dy) vëllime. Vëllimi i parë ka 204 (dyqind e katër) fletë, ndër të cilat 7 (shtatë) fletë kanë nivelin e klasifikimit “Tepër sekret” dhe 105 (njëqind e pesë) fletë kanë nivelin e klasifikimit “Sekret”, ndërsa vëllimi i dytë ka 96 (nëntëdhjetë e gjashtë) fletë, ndër të cilat 2 (dy) fletë kanë nivelin e klasifikimit “Tepër sekret” dhe 45 (dyzet e pesë) fletë kanë nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket fondit Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë.

11. Dosje e problemit të centralizuar “Karavidhet” nr. 1141, me 141 (njëqind e dyzet e një) fletë, ndër të cilat 67 (gjashtëdhjetë e shtatë) fletë kanë nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket fondit Dega IV.

12. Dosje personale 13648, në ngarkim të B.B., me 64 (gjashtëdhjetë e katër) fletë, ndër të cilat 4 (katër) fletë kanë nivelin e klasifikimit “Tepër sekret” dhe 23 (njëzet e tre) fletë kanë nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë.

13. Dosje pune 13648, në ngarkim të B.B., me 20 (njëzet) fletë, ndër të cilat 1 (një) fletë ka nivelin e klasifikimit “Tepër sekret” dhe 1 (një) fletë ka nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë.

14. Dosje personale nr. 1911, në ngarkim të K.S., me 39 (tridhjetë e nëntë) fletë ndër të cilat 17 (shtatëmbëdhjetë) fletë kanë nivelin e klasifikimit “Tepër sekret” dhe 8 (tetë) fletë kanë nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Dega e Punëve të Brendshme Shkodër.

15. Dosje pune nr. 1911, në ngarkim të K.S., me 61 (gjashtëdhjetë e një) fletë ndër të cilat 2 (dy) fletë kanë nivelin e klasifikimit “Tepër sekret”. Dosja i përket Fondit Dega e Punëve të Brendshme Shkodër.

16. Dosje formulare nr. 8301, në ngarkim të G.T., me 26 (njëzet e gjashtë) fletë, ndër të cilat 2 (dy) fletë kanë nivelin e klasifikimit “Tepër sekret” dhe 17 (shtatëmbëdhjetë) fletë kanë nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë.

17. Dosje formulare nr. 1986, në ngarkim të H.L., me 12 (dymbëdhjetë) fletë, ndër të cilat 2 (dy) fletë kanë nivelin e klasifikimit “Tepër sekret” dhe 3 (tri) fletë kanë nivelin e klasifikimit



“Sekret”. Dosja i përket Fondit Operativ.

18. Dosje përpunimi nr. 9, në ngarkim të Ç.M., me 130 (njëqind e tridhjetë) fletë, ndër të cilat 17 (shtatëmbëdhjetë) fletë kanë nivelin e klasifikimit “Tepër sekret” dhe 8 (tetë) fletë kanë nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Dega e Punëve të Brendshme Pukë.

19. Dosje përpunimi nr. 1250, në ngarkim të R.G., me 333 (treqind e tridhjetë e tre) fletë, ndër të cilat 79 (shtatëdhjetë e nëntë) fletë kanë nivelin e klasifikimit “Tepër sekret” dhe 100 (njëqind) fletë kanë nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë.

20. Dosje formulare nr. 2229, në ngarkim të R.A., me 123 (njëqind e njëzet e tre) fletë, ndër të cilat 9 (nëntë) fletë kanë nivelin e klasifikimit “Tepër sekret” dhe 13 (trembëdhjetë) fletë kanë nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Operativ.

KRYETARE
Gentiana Sula

VENDIM

Nr. 5, datë 25.2.2022

BIBLIOGRAFIA E INFORMACIONIT TË DEKLASIFIKUAR NË AIDSSH

Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.2.1999, “Për informacionin e klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”, të ndryshuar, kreu III, neni 13, pika “b”; në vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 662, datë 15.11.2017, “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”, kreu II, neni 4, pikat “a”, “c”; dhe në udhëzimin nr. 99, datë 13.4.2018, “Për zbatimin e vendimit nr. 662, datë 15.11.2017, për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”, Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “Sekret shtetëror”, në AIDSSH, i ngritur me urdhrin nr. 13, datë 3.5.2018 të kryetarit të Autoritetit “Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”, të ndryshuar në AIDSSH”, ka bërë deklasifikimin e informacionit të klasifikuar ‘Sekret shtetëror’, me vendimin nr. 5 datë 25.2.2022, si më poshtë:

I. Deklasifikoi plotësisht informacionet e mëposhtme:

1. Dosje e problemit të centralizuar nr. 1140, në ngarkim të S.H., me 72 (shtatëdhjetë e dy) fletë, ndër të cilat 24 (njëzet e katër) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Dega IV.

2. Dosje formulare nr. 4358, në ngarkim të R.H., me 147 (njëqind e dyzet e shtatë) fletë, ndër të cilat 26 (njëzet e gjashtë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Tepër sekret” dhe 5 (pesë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Operativ.

3. Dosje formulare nr. 4830, në ngarkim të XH.T., me 257 (dyqind e pesëdhjetë e shtatë) fletë, ndër të cilat 4 (katër) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Tepër sekret” dhe 68 (gjashtëdhjetë e tetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Operativ.

4. Dosje formulare nr. 2650, në ngarkim të F.T., me 355 treqind e pesëdhjetë e pesë fletë, ndër të cilat 38 (tridhjetë e tetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Tepër sekret”. Dosja i përket Fondit Operativ.

5. Dosje formulare nr. 3774, në ngarkim të K.T., me 100 (njëqind) fletë, ndër të cilat 2 (dy) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Tepër sekret” dhe 42 (dyzet e dy) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Operativ.

6. Fashikull për të dënuar nr. 3774, në ngarkim të K.T., me 8 (tetë) fletë, ndër të cilat 1 (një) fletë është e klasifikuar me nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Operativ.

7. Dosje me implikime për I.A., me 4 (katër) fletë, ndër të cilat 1 (një) fletë është e klasifikuar me nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Dega IV (Fondi Rezervë).

8. Dosje formulare nr. 2685, L.Ç., me 18 (tetëmbëdhjetë) fletë, ndër të cilat 1 (një) fletë është e klasifikuar me nivelin e klasifikimit “Tepër sekret” dhe 12 (dymbëdhjetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Dega e Punëve të Brendshme Berat.

9. Dosje formulare nr. 6877, XH.T., me 70 (shtatëdhjetë) fletë, ndër të cilat 6 (gjashtë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Tepër sekret” dhe 6 (gjashtë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket



Fondit Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë.

10. Dosje formulare nr. 9451, M.H., 126 (njëqind e njëzet e gjashtë) fletë, ndër të cilat 4 (katër) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Tepër sekret” dhe 21 (njëzet e një) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë.

11. Dosje formulare nr. 9655, Y.B., me 123 (njëqind e njëzet e tre) fletë, ndër të cilat 3 (tre) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Tepër sekret” dhe 32 (tridhjetë e dy) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë.

12. Dosje me implikime nr. 45 për P.M., me 2 (dy) fletë, ndër të cilat 1 (një) fletë është e klasifikuar me nivelin e klasifikimit “Tepër sekret” dhe 1 (një) fletë është e klasifikuar me nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Dega IV (Fondi Rezervë).

13. Dosje formulare nr. 1815, H.H., me 57 (pesëdhjetë e shtatë) fletë, ndër të cilat 5 (pesë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Tepër sekret” dhe 17 (shtatëmbëdhjetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Dega e Punëve të Brendshme Kukës.

14. Regjistër agjenture nr. 1, model K.I., me 48 (dyzet e tetë) fletë, ndër të cilat 1 (një) fletë është e klasifikuar me nivelin e klasifikimit “Tepër sekret”. Regjistri i përket Fondit Dega e Punëve të Brendshme Pukë.

15. Dosje përpunimi nr. 11285, F.L.L., me 12 (dymbëdhjetë) fletë, ndër të cilat 1 (një) fletë është e klasifikuar me nivelin e klasifikimit “Tepër sekret” dhe 10 (dhjetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë.

16. Fashikull për të dënuar, F.L.L., me 27 (njëzet e shtatë) fletë, ndër të cilat 3 (tri) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Tepër sekret” dhe 1 (një) fletë është e klasifikuar me nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë.

17. Dosje formulare nr. 1446, F.G., me 28 (njëzet e tetë) fletë, ndër të cilat 2 (dy) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Tepër sekret” dhe 13 (trembëdhjetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket

Fondit Dega e Punëve të Brendshme Pukë.

18. Dosje përpunimi nr. 2654, H.M., me 224 (dyqind e njëzet e katër) fletë, ndër të cilat 3 (tre) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Tepër sekret” dhe 32 (tridhjetë e dy) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Dega e Punëve të Brendshme Fier.

19. Dosje nr. 193, “Telegram mbi vdekjen e E.Ç. në Romë”, me 2 (dy) fletë, ndër të cilat 1 (një) fletë është e klasifikuar me nivelin e klasifikimit “Tepër sekret”. Dosja i përket Fondit Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit.

20. Dosje nr. 236, “Informacion i DSU-së për specialistët e huaj që punojnë në Mjekës”, me 11 (njëmbëdhjetë) fletë, ndër të cilat 2 (dy) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit.

21. Dosje nr. 237, “Informacion i Drejtorisë së Parë për problemet teknologjike të kompleksit kimik të Mjekësit”, me 10 (dhjetë) fletë, ndër të cilat 5 (pesë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit.

22. Dosje nr. 173, “Informacion i Drejtorisë së Parë për problemet lidhur me ndërtim-montimin në kompleksin kimik të Mjekësit”, me 25 (njëzet e pesë) fletë, ndër të cilat 8 (tetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit.

23. Dosje nr. 48, “Për disa probleme shqetësuese në uzinën e Mjekësit”, me 23 (njëzet e tre) fletë, ndër të cilat 7 (shtatë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit.

24. Dosje nr. 142, “Informacione dërguar ministrit MMP, mbi disa probleme në ndërtimin e kompleksit në Mjekës dhe punimet fortifikuese mbrojtëse”, me 22 (njëzet e dy) fletë, ndër të cilat 7 (shtatë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit.

25. Dosje nr. 56, “Informacione të Drejtorisë së Parë, mbi veprimtarinë armiqësore të specialistëve suedezë në komplekset në Mjekës”, me 7 (shtatë) fletë, ndër të cilat 2 (dy) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”.



Dosja i përket Fondit Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit.

26. Dosje nr. 253, “Informacione të Drejtorisë së Parë mbi disa probleme shqetësuese në uzinën e Mjekësit”, me 7 (shtatë) fletë, ndër të cilat 3 (tre) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit.

27. Dosje nr. 183, “Për shkelje të rregullave të sigurimit teknik dhe Uzinën Kimike të Mjekësit”, me 5 (pesë) fletë, ndër të cilat 2 (dy) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit.

28. Dosje nr. 171, “Për disa probleme në Uzinën Kimike të Mjekësit”, me 7 (pesë) fletë, ndër të cilat 2 (dy) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit.

29. Dosje nr. 190, “Informacion i DSU-së për disa probleme shqetësuese në Uzinën Kimike të Mjekësit”, me 16 (gjashtëmbëdhjetë) fletë, ndër të cilat 7 (shtatë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit.

30. Dosje nr. 248, “Për disa shqetësime në uzinën kimike të Mjekësit”, me 5 (pesë) fletë, ndër të cilat 2 (dy) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit.

31. Dosje nr. 399, “Për shkelje të rregullave të procesit teknologjik në Uzinën Kimike të Mjekësit”, me 3 (tri) fletë, ndër të cilat 1 (një) fletë është e klasifikuar me nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit.

32. Dosje nr. 274, “Informacion i Prokurorisë së Përgjithshme në drejtim të B.B.”, me 8 (tetë) fletë, ndër të cilat 2 (dy) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit.

33. Dosje nr. 125, “Informacion mbi N.K. dhe persona të tjerë që janë në përpunim aktiv” me 11 (njëmbëdhjetë) fletë, ndër të cilat 6 (gjashtë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit.

34. Dosje nr. 470, “Informacion mbi dhënien e shtetësisë shqiptare H.H. dhe disa personave të tjerë”, me 25 (njëzet e pesë) fletë, ndër të cilat 13

(trembëdhjetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit.

KRYETARE
Gentiana Sula

VENDIM
Nr. 24, datë 14.2.2022

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
LICENCIMIN E SHOQËRISË “HEC
TERFOJA” SHPK, NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE NGA HEC “TËRFOJE”, ME
KAPACITET TË INSTALUAR 1980 kw**

Në mbështetje të nenit 16 dhe të nenit 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 4, pika 1, germa “a”, nenit 5, pika 1, germa “a”, nenit 10, pika 3 dhe nenit 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 14.2.2022, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 204/2 prot., datë 2.2.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “HEC Terfoja” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Tërfoje” me kapacitet të instaluar 1980 kw”,

konstatoi se:

- Shoqëria “HEC Terfoja” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 175 prot., datë 24.1.2022, ka paraqitur aplikimin për t’u pajisur me licencë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

- Shoqëria “HEC Terfoja” sh.p.k. ka kryer pagesën e aplikimit në zbatim të aneksit A, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të



miratuar me vendimin e Bordit të (ERE), nr. 109, datë 29.6.2016”, të ndryshuar.

- Nga analiza e dokumentacionit në fazën e fillimit të procedurave të licencimit në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, për shoqërinë “HEC Terfoja” sh.p.k., rezulton se subjekti plotëson kryesisht kërkesat e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si më poshtë:

- formati dhe dokumentacioni për aplikim, neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b”, “c”: plotësuar;

- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”, “f”, “g”: plotësuar;

- dokumentacioni financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3, gjerat “a”, “b” dhe “d”: plotësuar;

- të dhëna teknike për bllokun e transformimit dhe lidhjen me sistemin, neni 9, pika 4.1.2: plotësuar;

- dokumentacioni teknik dhe grafik, neni 9, pika 4.1.3, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”: plotësuar;

- dokumentacioni tekniko-ekonomik, neni 9, pika 4.1.4, gjerat “a”, “b”, “c”: plotësuar;

- leje nga institucione të tjera, neni 9, pika 4.1.5, gjerat “a”, “b”: plotësuar.

- Në lidhje me mungesën e dokumentacionit, që ka të bëjë, me:

Dokumentacionin financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3:

germa “c” (dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit, ku shprehen qartë vlerat monetare për financimin dhe struktura e financimit (financim i vetë aplikuesit, kredi bankare, donacion, të tjera)): plotësuar pjesërisht. Shoqëria duhet të bëjë me dije ERE-n, se në cilën fazë ndodhen punimet dhe nëse është nënshkruar ndonjë rinovim i kontratës së sipërmarrjes për përfundimin e punimeve të ndërtimit, vlera e të cilave mbulon përafërsisht 1/3 e gjithë vlerës së investimit. Shoqëria duhet të depozitojë në ERE kontratën e rinovuar për vijimin e punimeve. Po ashtu, duke qenë se kontrata e depozituar në ERE e shoqërisë “HEC Terfoja” sh.p.k. me bankën, për financimin e HEC “Tërfoje” nuk është konkretizuar ende, shoqëria duhet të paraqesë në ERE dokumentacion mbështetës për të provuar kapacitetin financiar të saj për mbulimin e shpenzimeve të ndërtimit, nisur

nga vlera e investimit të nënshkruar në kontratën koncesionare me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), si dhe të sjellë informacion në ERE mbi aplikimin/miratimin në MIE të ndryshimit të ortakëve në kuptim të nenit 15, të kontratës nr. 1173 rep., nr. 510/3 kol., datë 30.5.2018, të “HEC Terfoja” sh.p.k.

Dokumentacioni teknik për HEC, neni 9, pika 4.1.1 – Të dhëna teknike për HEC:

- Të dhëna për centralin prodhues HEC “Tërfoje”: plotësuar pjesërisht. Shoqëria duhet të paraqesë në ERE të dhënat e munguara në lidhje me tensionin në dalje të gjeneratorit, si dhe të japë informacion mbi skedulën e punimeve dhe datën e fillimit të operimit, sikurse të plotësuar në deklaratë.

Dokumentacioni tekniko-ekonomik, neni 9, pika 4.1.4:

- germa “c”, (Miratimi i projektit të zbatimit nga MIE): plotësuar pjesërisht. Ky dokument citohet në kontratën me MIE-n, ndaj shoqëria duhet të paraqesë miratimin përfundimtar të Projektit të HEC “Tërfoje” nga MIE, në formën e kërkuar nga rregullorja e licencimit.

Leje nga institucione të tjera, neni 9, pika 4.1.5:

- germa “c”, (Leja mjedisore: plotësuar pjesërisht). Shoqëria duhet të paraqesë informacion në lidhje me fillimin e punimeve për ndërtimin e HEC-it, të shoqëruar me lejen e ndërtimit (nëse ka) apo fazën në të cilën ndodhet projekti, në mënyrë që të mundësohet llogaritja e vlefshmërisë së VNM-së paraprake, për këtë aplikim.

- Në lidhje me kalimin e kuotave, shoqëria në zbatim të nenit 15 të kontratës me MIE-n duhet të depozitojë në ERE miratimin/pëlqimin paraprak të autoritetit kontraktor, për këtë kalim, si dhe kontratat për shitblerjen e kuotave, duke qenë se shitja ka ndodhur pas nënshkrimit të kontratës nr. 1173 rep., nr. 510/3 kol., datë 30.5.2018, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit “Tërfoje me kapacitet prodhues 1.980 mw, në pellgun ujëmbledhës të përroit të fshatit dhe përroit të madh, degë e lumit Bushtricë, Bashkia Kukës, qarku Kukës”, lidhur midis MIE-s dhe mbajtësit të miratimit shoqërisë “HEC Terfoja” sh.p.k.

Në lidhje me kontratën e qirasë me Administratën Rajonale të Zonave të Mbrojtura Kukës, shoqëria duhet të bëjë me dije ERE-n, në lidhje me afatin për të cilin i nevojitet kjo kontratë, duke qenë se rezulton edhe e regjistruar në



ZVRPP-në respektive. Pasi, në rrethanat që kjo kontratë mund të duhet përgjatë gjithë kohës së vlefshmërisë së kontratës me MIE-n, shoqërisë i duhet që në përfundim të afatit të saj (data e përfundimit 27.3.2022), ta depozitojë me afat të rinovuar, jo më vonë se data 27.4.2022. Po ashtu, duke qenë se kemi të bëjmë me zhvillimin e projektit në një zonë të mbrojtur, shoqëria duhet të sigurojë/dokumentojë të drejtën për të operuar në atë zonë, nga institucionet përgjegjëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

- Shoqëria duhet të bëjë me dije në lidhje me fillimin apo fazën e punimeve, duke qenë se afati 12-mujor nga hyrja në fuqi e kontratës me MIE-n ka kaluar dhe, gjithashtu, për faktin se me fillimin e punimeve lidhet edhe vlefshmëria e lejes mjedisore. Shoqëria duhet të na informojë nëse ka nënshkruar me MIE-n ndonjë marrëveshje në kuptim të pikës 3, të nenit 9, “Programi i punimeve”, të kontratës, i cili citon, se: “... afatet mund të ndryshohen me marrëveshje midis MIE-s dhe mbajtësit të miratimit ...”.

- Në përfundim të afatit të lejes së shfrytëzimit të burimit ujor (data e përfundimit 23.1.2023), do t'i kërkohej shoqërisë ta depozitojë lejen nga baseni ujor, me afat të rinovuar, jo më vonë se data 23.2.2023.

- Në lidhje me mungesën e dokumentacionit të mësipërm do të njoftohet subjekti, që në bazë të neneve 10, pikat 10 dhe 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, t'i paraqesë ato brenda afateve.

- Kontrata nr. 1173 rep., nr. 510/3 kol., datë 30.5.2018, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit “Terfojë, me kapacitet prodhues 1.980 mw, në pellgun ujëmbledhës të përroit të fshatit dhe përroit të madh, degë e lumit Bushtricë, Bashkia Kukës, Qarku Kukës.”, lidhur midis MIE-s dhe mbajtësit të miratimit, shoqërisë “HEC Terfoja” sh.p.k., ka një afat 49-vjeçar, por ERE, në zbatim të nenit 38, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar dhe nenit 5, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nuk mund të japë për veprimtarinë e

prodhimit të energjisë elektrike një licencë me afat më të madh se 30 vjet.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “HEC Terfoja” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Terfoje”, me kapacitet të instaluar 1980 kw, për një afat 30-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 25, datë 14.2.2022

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “HEC TERFOJA” SHPK, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; i ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “e”, nenit 5, pika 1, germa “e”, nenit 10, pika 3, të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 19, pika 1, germa “a”, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar



me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 14.2.2022, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 204/3 prot., datë 2.2.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “HEC Terfoja” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “HEC Terfoja” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 175 prot., datë 24.1.2022 ka paraqitur aplikimin për t’u pajisur me licencë në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Shoqëria “HEC Terfoja” sh.p.k., ka kryer pagesën e aplikimit në zbatim të aneksit A, të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- Nga shqyrtimi i dokumentacionit në fazën e fillimit të procedurave të licencimit në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për shoqërinë “HEC Terfoja” sh.p.k., rezulton se subjekti plotëson kryesisht kërkesat e rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si më poshtë:

- Format i dhe dokumentacioni për aplikim. Neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b” dhe “c”. Plotësuar.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor. Neni 9, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”. Plotësuar.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal. Neni 9, pika 3, gjerat “a”, “b”, “d”. Plotësuar.

- Në lidhje me mungesën e dokumentacionit, që ka të bëjë me:

Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor. Neni 9, pika 2:

- gjerat “d” (vërtetimi nga Prokuroria dhe Gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë). Plotësuar pjesërisht. Shoqëria duhet të depozitojë në ERE vërtetimet e gjykatës dhe të prokurorisë me data të përditësuara.

- gjerat “e” (struktura e ndërtimit dhe funksionimit administrativ të shoqërisë, sipas pozicioneve dhe profileve përkatëse). Plotësuar pjesërisht. Shoqëria duhet të përcjellë në ERE strukturën e organizmit të saj ku të përfshihet edhe

stafi përkatës për veprimtarinë e tregtimit të energjisë.

Dokumentacioni financiar dhe fiskal. Neni 9, pika 3:

- gjerat “c” (dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit, ku shprehen qartë vlerat monetare për financimin dhe struktura e financimit (financim i vetë aplikuesit, kredi bankare, donacion të tjera), pa plotësuar. Shoqëria duhet të depozitojë në ERE sa kërkon kjo pikë e rregullores.

Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike. Neni 9, pika 4.8:

- gjerat “a” (sasia e energjisë elektrike e parashikuar për t’u tregtuar në GWh/sipas viteve); pa plotësuar. Shoqëria duhet të paraqesë sasinë e energjisë të parashikuar për t’u tregtuar në GWh për pesë vitet e licencës;

- gjerat “b” (kapitali financiar i parashikuar për ushtrimin e këtij aktiviteti); pa plotësuar. Shoqëria duhet të paraqesë në ERE dokumentacionin përkatës, do të njoftohet subjekti që në bazë të neneve 10, pikat 10 dhe 11, të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, t’i paraqesë ato brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “HEC Terfoja” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**VENDIM****Nr. 26, datë 14.2.2022**

**MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË
BLERJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE TË
PRODHUAR NGA BURIMET E VOGLA
TË RINOVUESHME NGA DIELLI DHE
NGA PJESA E BIODEGRADUESHME E
MBETJEVE TË NGURTA QË
SHFRYTËZOJNË MBETURINAT
INDUSTRIALE, URBANE DHE RURALE
PËR VITIN 2021**

Në mbështetje të nenit 10, pika 3, të ligjit nr. 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, nenit 90, të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 369, datë 26.4.2017, “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era”; VKM-së nr. 27, datë 17.1.2018, “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga gjeneratorët e vegjël me burime të rinovueshme nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta, që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale”; VKM-së nr. 580, datë 28.8.2019, “Për miratimin e planit të konsoliduar kombëtar të veprimtimit për burimet e rinovueshme të energjisë, 2019–2020”, e ndryshuar, dhe nenit 15, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 14.2.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur me nr. 236/3 prot., datë 11.2.2022, nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale për vitin 2021”,

konstatoi se:

- ERE është autoriteti përgjegjës për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme me kapacitet të instaluar të energjisë

elektrike deri në 2 mw dhe me kapacitet të instaluar të energjisë elektrike deri në 3 mw për energjinë e erës, në përputhje me metodologjitë e miratuara nga Këshilli i Ministrave.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 222, datë 9.11.2021, vendosi fillimin e procedurës “Mbi përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli, era dhe nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale për vitin 2021”.

- Në vijim të vendimmarrjes së sipërcituar, ERE me shkresën nr. 1111 prot., datë 26.11.2021 njoftoi Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrinë e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, Autoritetin e Konkurrencës, si dhe Agjencinë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve lidhur me fillimin e procedurës për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli, era dhe nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale për vitin 2021.

- Autoriteti i Konkurrencës, me anë të shkresës nr. 499/2, datë 7.12.2021, është shprehur se kjo procedurë nuk bie në kundërshtim me ligjin nr. 9121, datë 28.7.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

- ERE, me shkresën nr. 1120 prot., datë 2.12.2021, i kërkoi informacion MIE-s, mbi subjektet të cilat kanë marrë autorizimin paraprak apo miratimin përfundimtar për ndërtimin e veprave për prodhimin e energjisë elektrike nga burime të vogla të rinovueshme nga dielli dhe era; si dhe për gjeneratorë të vegjël me burim të rinovueshëm nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta, që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale për vitin 2021.

- MIE, me shkresën nr. 8779/1 prot., datë 20.12.2021, bëri me dije, ndër të tjera, se:

- ka pranuar shqyrtimin e 17 kërkesave për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet 2 mw secila, dhe do të njoftojë ERE-n për përfundimin e procedurave ligjore lidhur me miratimet paraprake që do të lëshohen brenda vitit 2021;

- janë lëshuar 7 miratime paraprake, prej të cilave 5 miratime paraprake me kapacitet prodhues me nga 3 mw, 2 miratime paraprake me kapacitet



prodhues me nga 2 mw dhe 1 miratim përfundimtar me kapacitet 2 mw , gjatë vitit 2021;

- për ndërtimin e impianteve prodhuese të energjisë elektrike nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta, që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale, pranë MIE-s, nuk është paraqitur asnjë kërkesë gjatë vitit 2021.

- ERE, me anë të shkresës nr. 62 prot., datë 13.1.2022, me qëllim vijimin dhe finalizimin e procesit të nisur me vendimin nr. 222, datë 9.11.2021, të Bordit të ERE-s, i kërkoj MIE-s informacion mbi statusin e aplikimeve të cilësuar në shkresën nr. 1120 prot., datë 2.12.2021 për vitin 2021.

- MIE, me anë të shkresës nr. 346/1 prot., datë 25.1.2022 bëri me dije se, ka lëshuar:

- 16 miratime paraprake për ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese të energjisë elektrike fotovoltaike me kapacitet 2 mw secila, dhe ka pranuar shqyrtimin e 8 aplikimeve me kapacitet me nga 2 mw secila, të cilat janë në fazë vlerësimi;

- 7 miratime paraprake për ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese të energjisë elektrike eolike, prej të cilave 5 miratime paraprake me kapacitet prodhues me nga 3 mw secila, 2 miratime paraprake me kapacitet prodhues 2 mw secila dhe 1 miratim përfundimtar me kapacitet të instaluar 2 mw.

- Në kushtet kur:

- MIE-ja ende nuk ka përfunduar procesin e vlerësimit të aplikimeve për teknologjitë fotovoltaike deri në 2 mw, teknologjitë eolike deri në 3 mw dhe ka bërë me dije se për ndërtimin e impianteve prodhuese të energjisë elektrike nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta, që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale, nuk është paraqitur asnjë kërkesë për vitin 2021;

- Procesi i finalizimit të dhënies së miratimeve përfundimtare për ndërtimin e centraleve prodhuese nga këto teknologji është në fazë vlerësimi dhe do të vijojë përgjatë vitit 2022;

- Nuk gjen zbatim përcaktimi i çmimit për këto teknologji, në mungesë të kostove konkrete të investimit për vitin 2021.

- Në aspektin procedural, bëhet e nevojshme mbyllja e procedurës së nisur me vendimin nr. 222, datë 9.11.2021, të Bordit të ERE-s, lidhur me përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të

rinovueshme nga dielli dhe nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale për vitin 2021.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Përfundimin e procedurës administrative të nisur me vendimin nr. 222, datë 9.11.2021, mbi përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale për vitin 2021.

2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrinë e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, Autoritetin e Konkurrencës, si dhe Furnizuesin e Tregut të Lirë sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti



VENDIM

Nr. 27, datë 14.02.2022

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË BLERJES
SË ENERGJISË ELEKTRIKE TË
PRODHUAR NGA BURIMET E VOGLA
TË RINOVUESHME NGA DIELLI, ERA
DHE NGA PJESA BIODEGRADUESHME
E MBETJEVE TË NGURTA QË
SHFRYTËZOJNË MBETURINAT
INDUSTRIALE, URBANE DHE RURALE
PËR VITIN 2022**

Në mbështetje të nenit 10, pika 3, të ligjit nr. 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 369, datë 26.4.2017, “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era”; VKM-së nr. 27, datë 17.1.2018, “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga gjeneratorët e vegjël me burime të rinovueshme nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta, që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale” dhe rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 14.2.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur me nr. 236/4 prot., datë 11.2.2022, nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi fillimin e procedurës për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli, era dhe nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale për vitin 2022”,

konstatoi se:

- VKM nr. 369, datë 26.4.2017, “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era”, në pikën 2 të saj, ngarkon ERE-n me detyrimin për miratimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era, në përputhje me çmimin e

mesatarizuar për vitin 2017, sipas parashikimeve të kësaj metodologjie, bazuar në referencat e tabelës së paraqitur në këtë VKM për sa i takon LCOE dhe WACC ose të dhënave konkrete të kostove të investimeve që mund të sigurohen për vitet në vijim.

- VKM nr. 27, datë 17.1.2018, “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga gjeneratorët e vegjël me burime të rinovueshme nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta, që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale”, përcakton, ndër të tjera, se për investimet për të cilat subjektet janë pajisur me autorizimin përkatës pas datës 1 janar 2018 e në vijim, ERE do të miratojë çmimin në bazë të të dhënave të grumbulluara, për sa i përket kostove reale të investimit, nëse rezultojnë të ndryshme nga parashikimet e kësaj metodologjie.

- Metodologjia e miratuar me VKM-në nr. 369, datë 26.4.2017, përcakton kriteret e llogaritjes së çmimit, duke u bazuar në kthimin e arsyeshëm të vlerës së investimeve, sipas llojit të teknologjisë së përdorur.

- Ndërkohë, metodologjia e miratuar me VKM-në nr. 27, datë 17.1.2018, përcakton kriteret e llogaritjes së çmimit që duhet të paguhet për një njësi output si pagesë për fuqinë e prodhuar, me qëllim që të arrihet një rikthim financiar i caktuar – ose të vendoset thjesht çmimi që projekti duhet të fitojë për mwh, me qëllim që të arrihet *break-even* ose të ardhurat të barazojnë kostot e prodhimit.

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka lëshuar: 1) autorizimin paraprak; 2) miratimin përfundimtar për ndërtimin e veprave për prodhimin e energjisë elektrike nga burime të vogla të rinovueshme nga dielli dhe era; si dhe gjeneratorët e vegjël me burim të rinovueshëm nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta, që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale.

- Ky informacion do të shërbejë për vlerësimin dhe shqyrtimin e të dhënave të nevojshme për llogaritjen e çmimeve për teknologjitë në fjalë, mbështetur në përcaktimet e legjislacionit në fuqi.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar



nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli, era dhe nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale për vitin 2022.

2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë palët e interesit dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrir Ahmeti

VENDIM
Nr. 28, datë 14.2.2022

**MBI KËRKESËN E OSSH SHA, PËR
NDRYSHIMIN E VENDIMIT TË ERE-s
NR. 181, DATË 23.11.2016, “PËR DISA
NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 104,
DATË 23.6.2016, TË BORDIT TË ERE-s,
‘MBI PËRCAKTIMIN E
METODOLOGJISË SË VLERAVE
REFERUESE, NË RAST SE TË DHËNAT
E MATJES JANË PËRKOHËSISHT TË
PADISPONUESHME DHE TË
PAARRITSHME, SI DHE MBI
SHFUQIZIMIN E VENDIMEVE TË ERE-s
NR. 49, DATË 21.10.2004, DHE NR. 146,
DATË 24.12.2013”**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 76, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 15 dhe 26, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 3.9.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 14.2.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike, me nr. 128/4

prot., datë 24.1.2022, “Mbi shqyrtimin e kërkesës së OSSH sh.a., për ndryshimin e vendimit të ERE-s nr. 181, datë 23.11.2016, Për disa ndryshime në vendimin nr. 104, datë 23.6.2016, të Bordit të ERE-s, Mbi përcaktimin e metodologjisë së vlerave referuese në rast se të dhënat e matjes janë përkohësisht të padisponueshme dhe të paarritshme, si dhe mbi shfuqizimin e vendimeve të ERE-s nr. 49, datë 21.10.2004 dhe nr. 146, datë 24.12.2013” dhe informacionin shtesë nr. 128/4-1 prot., datë 4.2.2022,

konstatoi se:

- OSSH sh.a., me shkresën nr. 4927/2 prot., datë 12.7.2021, pasi ka evidentuar dhe konsideruar problematikën në formulimin e pikës 2, germa “a”, të vendimit të ERE-s nr. 181, datë 23.11.2016, “Për disa ndryshime në vendimin nr. 104, datë 23.6.2016, të Bordit të ERE-s, Mbi përcaktimin e metodologjisë së vlerave referuese në rast se të dhënat e matjes janë përkohësisht të padisponueshme dhe të paarritshme, si dhe mbi shfuqizimin e vendimeve të ERE-s nr. 49, datë 21.10.2004 dhe nr. 146, datë 24.12.2013”, ka propozuar ndryshimin si vijon: “Kjo vlerë do të përllogaritet bazuar në të njëjtin konsum të muajit respektiv të vitit të mëparshëm. Periudha e faturimit sipas këtyre vlerave referuese nuk mund të zgjasë me shumë se tre muaj”.

- Në zbatim të urdhrit të kryetarit të ERE-s nr. 51, më datë 6.8.2021, ERE zhvilloi një seancë dëgjimore me përfaqësues të OSSH sh.a. Në këtë seancë, OSSH sh.a., iu kërkuar shpjegime lidhur me ndikimin e llojit të aktivitetit dhe shërbimit e shpërndarjes së energjisë elektrike. OSSH sh.a., nuk paraqiti ndonjë të dhënë lidhur me ndikimin që ka lloji i aktivitetit të subjektit për Operatorin e Sistemit që ofron shërbimin në mënyrë të barabartë për të gjithë klientët e lidhur në sistemin e shpërndarjes.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 217, datë 27.10.2021, vendosi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a., për ndryshimin e vendimit të ERE-s nr. 181, datë 23.11.2016, “Për disa ndryshime në vendimin nr. 104, datë 23.6.2016, të Bordit të ERE-s, Mbi përcaktimin e metodologjisë së vlerave referuese në rast se të dhënat e matjes janë përkohësisht të padisponueshme dhe të paarritshme, si dhe mbi



shfuqizimin e vendimeve të ERE-s nr. 49, datë 21.10.2004 dhe nr. 146, datë 24.12.2013”.

- ERE, nëpërmjet shkresës nr. 715/4 prot., datë 4.11.2021, ka kërkuar marrjen e opinioneve dhe komenteve nga një numër i madh palësh interesi, lidhur me nisjen e procedurës me miratimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 217/2021.

- ERE, duke marrë në konsideratë faktin se lloji i aktivitetit ndikon më shumë furnizuesit dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë FSHU sh.a., që faturon konsumatorët në tregun e rregulluar sipas çmimeve të miratuara nga ERE, sipas kategorive të konsumatorëve, me shkresën nr. 715/4 prot., datë 4.11.2021, ka kërkuar vlerësimin dhe opinionin e një numri të madh furnizuesish të licencuar përfshirë dhe FSHU sh.a. Asnjë nga këta furnizues nuk ka dhënë komente apo opinione lidhur me këtë propozim të OSSH sh.a., përfshirë këtu dhe FSHU sh.a.

- Përveç sa më sipër, në faqen e internetit të ERE-s në rubrikën “Konsultime” është publikuar propozimi i OSSH sh.a., për ndryshimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 181/2016, si dhe qëndrimi i Autoritetit të Konkurrencës i shprehur nëpërmjet shkresës nr. 471/2 prot., datë 7.12.2021, si përgjigje ndaj shkresës së ERE-s nr. 715/4 prot., datë 4.11.2021.

- Në vijim të procesit të konsultimeve, palët e interesit kanë dërguar në ERE qëndrimet përkatëse si më poshtë:

- Ministria se Infrastrukturës dhe Energjisë, nëpërmjet shkresës nr. 8013/1 prot., datë 16.12.2021 ka parashtruar se: “Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, pasi u njoh me propozimet e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes sh.a., të publikuara në faqen e internetit të Entit Rregullator në zërin ‘Konsultime’, shprehet dakord për vijimin e procedurës nga ana juaj, bazuar në vendimin nr. 217, datë 27.10.2021, të Bordit të ERE-s, dhe në zbatim të ligjit nr. 43/2015, ‘Për sektorin e energjisë elektrike’, të ndryshuar, dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij”.

- Autoriteti i Konkurrencës, nëpërmjet shkresës nr. 471/2 prot., datë 7.12.2021, ka parashtruar se: “... Nga sa më sipër, arrijmë në përfundimin se kjo procedurë është në mbështetje të neneve 16 dhe 76, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, ‘Për sektorin e energjisë elektrike’, i ndryshuar; dhe neneve 15, 19 dhe 26, të rregullores ‘Për organizimin,

funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 96, data 17.6.2016. Nga vlerësimi i këtij vendimi konstatohet se kjo procedurë nuk bie në kundërshtim me ligjin nr. 9121, datë 28.7.2003, ‘Për mbrojtjen e konkurrencës’, i ndryshuar”.

- OSSH sh.a., me shkresën nr. 10017/1 prot., datë 11.1.2022, protokolluar në ERE, me nr. 57 prot., datë 13.1.2022, parashtron se: “Duke qenë se OSSH sh.a. fillon ciklin e leximit të janarit 2022, mbetemi në pritje të vendimmarrjes finale nga ana juaj, në një kohë sa më shpejt në mënyrë aplikimin e metodologjisë së ndryshuar, duke filluar që në ciklin e parë të leximit për vitin 2022”.

- Lidhur me sa parashtruar nga OSSH sh.a., me shkresën nr. 10017/1 prot., datë 11.1.2022, është vlerësuar se përgjatë procesit të vendimmarrjes së ERE-s nuk ka asnjë vakum ligjor i cili pengon ecurinë e punës së Operatorit. Pretendimi për fillimin e aplikimit të kësaj metodologjie llogaritëse në janar 2022, është i parakohshëm dhe paragjykon vendimmarrjen finale të Bordit të ERE-s, e cila mund të jetë për pranimin apo rrëzimin e kërkesës së bërë nga OSSH sh.a.

- Lidhur mbi propozimin e OSSH sh.a., me shkresën nr. 4927/2 prot., datë 12.7.2021, lidhur me problematikën në formulimin e pikës 2, germa “a”, të vendimit të ERE-s nr. 181, datë 23.11.2016, vlerësojmë se:

- Riformulimi i cituar, nuk bie ndesh me nenin 76, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, ‘Për sektorin e energjisë elektrike’, i ndryshuar, i cili parashikon se: “Në rast se të dhënat e matjes janë përkohësisht të padisponueshme ose të paarrtshme për një periudhë më të gjatë se 1 muaj, operatorët e rrjetit llogarisin vlera reference zëvendësuese, bazuar në metodologjinë e miratuar nga ERE. Periudha e zbatimit të vlerave referuese nuk mund të zgjasë më shumë se 3 muaj”. Pra, periudha e zbatimit të vlerave referuese, sikurse reflektuar nga shoqëria OSSH sh.a., nuk mund të zgjasë më shumë se 3 muaj, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 43/2015, i ndryshuar.

- OSSH sh.a. vlerëson, se gjatë zbatimit të vendimeve të ERE-s, nr. 58/2020 dhe nr. 24/2021 ka përdorur vlerën referuese zëvendësuese, siç përcaktohet nga ERE në pikat respektive të këtyre vendimeve, të vetëm një viti më parë. Lidhur me këtë pretendim, vlerësohet se vendimi i ERE-s nr.



58/2020, është marrë në kushtet e emergjencës së pandemisë Covid-19. Në këto rrethana, duke qenë se përgjatë vitit 2021 ERE ka vazhduar punën normalisht, për vitin 2022 mund të përdoren të dhënat e vitit 2021.

- Lidhur me vlerësimin e bërë nga OSSH sh.a., se: “në rast se konsumi që do të faturohet muajin aktual, duke u bazuar në 3 vitet e mëparshme, nuk do të jetë i saktë dhe përdoruesi do ta ankimojë, përsëri ky rekord do të mbetet në historikun e tij të faturimit, duke bërë që edhe në të ardhmen nëse do të jetë subjekt i kësaj mënyre faturimi, përlogaritja do të jetë e gabuar”. Shpjegojmë se me mesataren vjetore apo me të njëjtin konsum mujor të një viti më parë, konsumi do të jetë real edhe nëse do të ketë muaj të keq faturuar (gjatë vitit), përsëri do të jenë bërë sistemimet me ankesë nga përdoruesi apo pa ankesë, si rrjedhojë e procesit të leximit të matësit.

- Sa më sipër, rezulton se përdoruesit/konsumatorët janë faturuar sipas vendimit të ERE-s nr. 181/2016, “Mbi disa ndryshime në vendimin nr. 104, datë 23.6.2016, ‘Mbi përcaktimin e metodologjisë së vlerave referuese në rast se të dhënat e matjes janë përkohësisht të padisponueshme dhe të paarrtshme, si dhe mbi shfuqizimin e vendimeve të ERE-s nr. 49, datë 21.10.2004 dhe nr. 146, datë 24.12.2013’”, por në kushte specifike është realizuar faturimi sipas përcaktimeve të vendimeve të ERE-s, nr. 58/2020 dhe nr. 24/2021. Në këto rrethana, vlerësohet se propozimi i OSSH sh.a., të pranohet dhe të aplikohet për periudhën 15.2.2022 deri më 31.12.2022. Kjo periudhë kohore do të shërbejë për të vlerësuar nëse kjo metodologji do të sjellë rritjen e saktësisë së vlerave referuese.

- Përgjatë kësaj periudhe kohore, Operatorët e Sistemit të raportojnë në ERE periodikisht çdo 2 (dy) muaj për ecurinë e aplikimit të kësaj metodologjie.

- Lidhur me kërkesën e bërë nga OSSH sh.a., për ndryshimin e pikës 2, germa “b”, të vendimit të ERE-s nr. 181, datë 23.11.2016, e cila propozohet të bëhet “Për kontratat e furnizimit me energji elektrike që nuk kanë faturime të muajit referues të vitit të mëparshëm të konsumit me matje të energjisë elektrike, faturimi me vlera referuese të bëhet bazuar në mesataren e konsumit me matje të energjisë elektrike, të regjistruar gjatë 12 muajve të fundit, në sistemin e faturimit”, sqarojmë se ky

ndryshim nuk adreson rastin kur konsumatorët nuk kanë referencë asnjë muaj të leximit të matjes së energjisë elektrike, si dhe kur konsumatorët kanë lexim matje të energjisë elektrike në një periudhë nga 1 (një) deri në 11 (njëmbëdhjetë) muaj.

- Lidhur me sa më sipër, vlerësohet se në rastin kur konsumatorët nuk kanë referencë asnjë muaj të leximit të matjes së energjisë elektrike është e pamundur që të aplikohet mekanizmi i vlerës referuese të muajit respektiv të vitit të mëparshëm apo ai i konsumit mesatar të matur. Në këto raste, mekanizmi i vetëm për aplikimin e vlerave referuese do të jetë faturimi me vlerë referuese 0 kWh, dhe sistemimi i faturës për këta konsumatorë do të realizohet në muajin pasardhës, ku të dhënat e matjes së energjisë elektrike janë të disponueshme.

- Në rastin kur konsumatorët kanë lexim matje të energjisë elektrike në një periudhë nga 1 (një) deri në 11 (njëmbëdhjetë) muaj, nuk mund të aplikohet mekanizmi i vlerës referuese të muajit respektiv të vitit të mëparshëm. Në këto raste, mekanizmi i vetëm për aplikimin e faturimit me vlerë referuese do të ishte faturimi me vlerën mesatare të konsumit për muajt e matur të konsumit të energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pranimin e pjesshëm të kërkesës së bërë nga OSSH sh.a. për ndryshimin e vendimit të ERE-s nr. 181, datë 23.11.2016, “Për disa ndryshime në vendimin nr. 104, datë 23.6.2016, të Bordit të ERE-s, ‘Mbi përcaktimin e metodologjisë së vlerave referuese në rast se të dhënat e matjes janë përkohësisht të padisponueshme dhe të paarrtshme, si dhe mbi shfuqizimin e vendimeve të ERE-s nr. 49, datë 21.10.2004 dhe nr. 146, datë 24.12.2013’”.

2. Të miratojë disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 104, datë 23.6.2016, të Bordit të ERE-s, “Mbi përcaktimin e metodologjisë së vlerave referuese në rast se të dhënat e matjes janë përkohësisht të padisponueshme dhe të paarrtshme, si dhe mbi shfuqizimin e vendimeve të ERE-s nr. 49, datë 21.10.2004, dhe nr. 146, datë 24.12.2013”, i ndryshuar, si më poshtë:

Pika 2, ndryshon dhe bëhet:



a) Në rastet kur furnizuesi merr dijeni nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes se të dhënat e matjes janë përkohësisht të padisponueshme ose të paarrtshme për një periudhë më të gjatë se një muaj (matësi është i dëmtuar, matësi është jashtë kushtit teknik apo mungon aksesit në të dhënat e matjes), faturimi i energjisë elektrike do të bëhet me vlerë referuese. Kjo vlerë do të përllogaritet bazuar në të njëjtin konsum të muajit respektiv të vitit të mëparshëm. Periudha e faturimit sipas këtyre vlerave referuese nuk mund të zgjasë me shumë se tre muaj.

3. Pas germës “ç”, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 104/2016, i ndryshuar me vendimin nr. 181/2016, shtohen germat “d” dhe “dh”, me përmbajtjen si vijon:

d) Konsumatorët që nuk kanë referencë asnjë muaj të leximit të matjes së energjisë elektrike do të faturohen me vlerë referuese 0 kWh.

dh) Konsumatorët që kanë lexim me matje të energjisë elektrike në një periudhë nga 1 (një) deri në 11 (njëmbëdhjetë) muaj, do të faturohen me vlerë referuese bazuar në vlerën mesatare për muajt e matur të konsumit të energjisë elektrike.

4. Ndryshimet e parashikuara në pikën 2, të këtij vendimi hyjnë në fuqi më datë 15 shkurt 2022 dhe i shtrijnë efektet juridike deri më 31 dhjetor 2022.

5. Me përfundimin e afateve të parashikuara në pikën 4, të këtij vendimi, për përcaktimin e vlerave referuese në rast se të dhënat e matjes janë përkohësisht të padisponueshme dhe të paarrtshme do të aplikohet metodologjia e parashikuar në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 104, datë 23.6.2016, i ndryshuar, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 181, datë 23.11.2016, “Për disa ndryshime në vendimin nr. 104, datë 23.6.2016, të Bordit të ERE-s, ‘Mbi përcaktimin e metodologjisë së vlerave referuese në rast se të dhënat e matjes janë përkohësisht të padisponueshme dhe të paarrtshme, si dhe mbi shfuqizimin e vendimeve të ERE-s nr. 49, datë 21.10.2004 dhe nr. 146, datë 24.12.2013’”.

6. Për periudhën e përcaktuar në pikën 4, të këtij vendimi, furnizuesit të cilët lëshojnë faturë me vlerë referuese, të raportojnë në ERE periodikisht çdo 2 (dy) muaj, jo më vonë se data 20 e muajit pasardhës të periudhës së raportimit, në lidhje me gjetjet e tyre mbi këto modalitete faturimi duke përfshirë analizë krahasimore të ankesave të regjistruara

përgjatë aplikimit, si dhe rezultatet e të dhënave reale të matjes.

7. Drejtoria e Mbrojtjes së Konsumatorit, Performancës dhe Standardeve të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 29, datë 14.2.2022

**MBI NDRYSHIMIN E PJESSHËM TË
PËRKOHSHËM TË VENDIMIT TË
BORDIT TË ERE-s NR. 146, DATË
10.9.2020, ‘MBI LICENCIMIN E
SHOQËRISË ‘SEKA HYDROPOWER’
SHPK, NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE NGA HEC-et ‘SEKË’, ME
KAPACITET TË INSTALUAR 12667 kw
DHE ‘ZAIS’, ME KAPACITET TË
INSTALUAR 2295 kw, ME KAPACITET
TOTAL TË INSTALUAR 14962 kw’**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 451 dhe 479, pika 1, germa “a”, të Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë, nenit 104, nenit 113 dhe nenit 67, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë dhe nenit 15, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 3.9.2016; Bordin i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 14.2.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike me nr. 236/2 prot., datë



9.2.2022, “Mbi shfuqizimin e pjesshëm të vendimit të bordit të ERE-s nr. 146, datë 10.9.2020 “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Seka Hydropower’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et ‘Sekë’ me kapacitet të instaluar 12667 kw dhe ‘Zais’, me kapacitet të instaluar 2295 kw, me kapacitet total të instaluar 14962 kw”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 146, datë 10.9.2020, vendosi të licencojë shoqërinë “Seka Hydropower” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et: “Sekë”, me kapacitet të instaluar 12667 kw dhe “Zais” me kapacitet të instaluar 2295 kw, me kapacitet total 14962 kw, për një afat 28-vjeçar.

- Vendimi nr. 146, datë 10.9.2020, i Bordit të ERE-s është ankimuar nga paditësit B.P., dhe të tjerë pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, e cila me vendimin nr. 49, datë 18.1.2021 ka vendosur ndër të tjera, pranimin e pjesshëm të kërkesë padisë së paraqitur nga paditësit dhe shfuqizimin e pjesshëm të aktit administrativ, vendimit nr. 146, datë 10.9.2020 të Bordit të ERE-s.

- Kundër këtij vendimi, “Seka Hydropower” sh.p.k., ERE dhe Avokatura e Shtetit kanë paraqitur ankim pranë Gjykatës Administrative të Apelit.

- Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 559 (86-2021-671), datë 10.11.2021 ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 49, datë 18.1.2021, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

- Kundër vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit, ERE, “Seka Hydropower” sh.p.k. dhe Avokatura e Shtetit ka paraqitur rekurs pranë Gjykatës së Lartë, Tiranë dhe kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit të gjykatave, konkretisht vendimit nr. 49/2021 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë dhe vendimit nr. 559/221 të Gjykatës Administrative të Apelit.

- Në nenin 451, germa “a”, e Kodit të Procedurës Civile, parashikohet se: “Vendimi që ka marrë formë të prerë është i detyrueshëm për palët”, ndërsa germa “ç” parashikon se: “Një vendim i gjykatës merr formë të prerë kur është lënë në fuqi, ndryshuar ose është pushuar gjykimi në shkallë të dytë”.

- Gjithashtu, Kodi i Procedurave Administrative në nenin 113, pika 1, parashikon se: “Një akt

administrativ mund të anulohet apo shfuqizohet, kryesisht nga organi publik që ka kompetencë të nxjerrë aktin. Pika 2, vijuese e këtij neni, përcakton se shfuqizimi i aktit administrativ ka pasoja vetëm për të ardhmen dhe se shfuqizimi mund të jetë i pjesshëm apo i tërësishëm”, ndërsa pika 3 përcakton formën ligjore të shfuqizimit të aktit, përkatësisht përmes një akti të ri me shkrim, i cili anulon, shfuqizon, ndryshon apo plotëson aktin e parë.

- Me paraqitjen e rekursit dhe kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit nr. 559 (86-2021-671), datë 10.11.2021 para Gjykatës së Lartë, si dhe kërkesave për plotësimin e të metave datë 28.1.2022 dhe datë 31.1.2022 kjo e fundit për sa përcaktuar në nenin 479, pika 1, germa “a”, të Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit.

- Në çdo rrethanë, në rast të marrjes së një vendimi nga Gjykata e Lartë për pranimin e rekursit dhe/ose kërkesës së paraqitur nga palët për pezullimin e ekzekutimit të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit, ERE rezervon të drejtën që në vijim të shprehet në përputhje dhe në zbatim të kësaj vendimmarrje.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Ndryshimin e pjesshëm të përkohshëm të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 146, datë 10.9.2020 “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Seka Hydropower’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et ‘Sekë’, me kapacitet të instaluar 12667 kw dhe ‘Zais’, me kapacitet të instaluar 2295 kw, me kapacitet total të instaluar 14962 kw”.

2. Pika 1 e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 146, datë 10.9.2020, ndryshon dhe bëhet:

“Të licencojë shoqërinë ‘Seka Hydropower’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Sekë’, me kapacitet të instaluar 12667 kw, për një afat 28-vjeçar”.

3. Pjesa tjetër e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 146, datë 10.9.2020 mbetet e pandryshuar. ERE ka të drejtë të rishikojë këtë vendim në varësi të vendimmarrjes nga Gjykata e Lartë për rekursin



dhe/ose kërkesën e paraqitur nga palët për pezullimin e ekzekutimit të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit.

4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “Seka Hydropower” sh.p.k., MIE dhe palët e interesuar për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2022

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 160 lekë